



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

# SUGJERIME MBI RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

## Shqipëria post COVID-19

Tiranë, Qershor 2020

**K**y dokument pune është përgatitur në kuadër të mbledhjes XXI të Këshillit të Investimeve (5 qershor 2020), nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe rregullator, znj. Elida Fara, eksperte për ekonominë, znj. Xaira Shurdha, eksperte për monitorimin dhe ndërlidhjen, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Mbështetje në organizimin dhe promovimin e anketës, kontaktimin e partnerëve dhe redaktimin gjuhësor të materialit u ofrua nga znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit. Një mirënjohje dhe falenderim të veçantë për drejtuesit e subjekteve private, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit (UCCIAL, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, FIAA, DIHA, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, Amcham, Confindustria Albania, KASH, etj.), institucionet shtetërore (MFE, BSH, MIE, MBZHR, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve – AKAFP, etj.) dhe projektin RisiAlbania që bashkëpunuan në mënyrë të shkëlqyer me Sekretariatit me sugjerime konkrete mbi opsionet e rimëkëmbjes ekonomike, si edhe debatet në procesin e konsultimit të materialit.

## LISTA E SHKURTIMEVE

|              |   |
|--------------|---|
| <b>AIDA</b>  | Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve |
| <b>ALL</b>   | Albanian Lek                                    |
| <b>BB</b>    | Banka Botërore                                  |
| <b>BKT</b>   | Banka Kombëtare Tregtare                        |
| <b>BSH</b>   | Banka e Shqipërisë                              |
| <b>BERZH</b> | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim      |
| <b>BP</b>    | Balkani Perëndimor                              |
| <b>DBE</b>   | Delegacioni i Bashkimit Evropian                |
| <b>FMN</b>   | Fondi Monetar Ndërkombëtar                      |
| <b>KI</b>    | Këshilli i Investimeve                          |
| <b>KIS</b>   | Komiteti i Investimeve Strategjike              |
| <b>MIE</b>   | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë       |
| <b>MBZHR</b> | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural      |
| <b>NVM</b>   | Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme                |
| <b>PBB</b>   | Prodhimi i Brendshëm Bruto                      |
| <b>SKI</b>   | Sekretariati i Këshillit të Investimeve         |
| <b>TEDA</b>  | Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik     |
| <b>TIK</b>   | Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit      |

## PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>HYRJE</b> .....  | <b>5</b>  |
| <b>HAPAT E NDJEKUR</b> .....                                  | <b>6</b>  |
| <b>KONTEKSTI</b> .....  | <b>7</b>  |
| <b>GJETJE</b> .....   | <b>9</b>  |
| VLERËSIME TË RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE.....                     | 9         |
| REZULTATET KRYESORE TË ANKETËS.....                           | 10        |
| NDËRHYRJET NË EKONOMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE KROACI..... | 11        |
| <b>SUGJERIME DHE REKOMANDIME</b> .....                        | <b>13</b> |
| SUGJERIME TË ANËTARËVE DHE PARTNERËVE TË KI.....              | 14        |
| REKOMANDIME ME FOKUS SEKTORIAL.....                           | 20        |
| <b>SHTOJCA 1</b> .....  | <b>24</b> |
| <b>SHTOJCA 2</b> .....  | <b>28</b> |
| <b>SHTOJCA 3</b> .....  | <b>36</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA</b> .....                                     | <b>38</b> |

## HYRJE

**P**andemia e COVID-19 u konfirmua zyrtarisht në Shqipëri më 8 mars 2020. Këshilli i Ministrave vendosi të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë më 24 Mars 2020.

Në përgjigje të situatës së paprecedentë të krijuar në vend, më 14 prill 2020, Këshilli i Investimeve zhvilloi një mbledhje të jashtëzakonshme për të diskutuar ndikimin e pandemisë së COVID-19 mbi biznesin në Shqipëri, me fokus masat financiare dhe ekonomike të mara nga qeveria për të përballuar në afatshkurtër pasojat e pandemisë, si edhe për të prezantuar gjetjet paraprake të Anketimit të realizuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve gjatë periudhës mars – prill 2020 me bizneset në vend.

Ndërkohë, me kërkesë të Kryetares së KI, anëtarët dhe partnerët e KI vendosën që masat në vijim duhen parë në një kuadër më të gjerë, në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Kjo me qëllim adresimin *jo vetëm të nevojave emergjente të biznesit përvoja të takon likuiditetit dhe punësimit, por edhe për të vendosur pikat e ridimensionimit të zhvillimit ekonomik*

*të vendit, burimeve të rritjes dhe realizimit të të ardhurave, vlerësimit të ndërhyrjeve fiskale dhe rimëkëmbjes së sektorëve prioritarë për një periudhë të paktën 5-vjeçare.* Kjo është në të njëjtën linjë me ambicidet dhe angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të prezantuar brenda muajit qershor, planin e rimëkëmbjes së ekonomisë dhe veçanërisht të sektorëve prioritarë si turizmi dhe manifaktura. Në këtë kontekst, për të stimuluar debatin, Sekretariati përveç përmbledhjes dhe evidentimit të ndërhyrjeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare<sup>1</sup>, sugjerimeve të anëtarëve dhe partnerëve të KI<sup>2</sup>, përgatiti edhe një matricë krahasuese<sup>3</sup> me masat e ndërmarra në vendet e rajonit në mbështetje të ekonomive të tyre. Në vijim, *ky material paraqet në mënyrë të përmbledhur shtyllat kryesore ku fokusohen rekomandimet dhe masat e paraqitura nga të gjithë partnerët e KI për të adresuar rimëkëmbjen ekonomike në afatmesëm dhe afatgjatë.*

1 Shtojca 1

2 Shtojca 3

3 Shtojca 2

## HAPAT E NDJEKUR

Në mënyrë të përmbledhur, hapat e ndërmarra nga Sekretariati, gjatë periudhës prill-maj 2020, për nxitjen e debatit mbi hulumtimin e opsioneve dhe sugjerimet e anëtarëve të KI mbi rimëkëmbjen ekonomike të vendit janë si më poshtë vijon:

- (i) Anketa e Sekretariatit të Këshilli Investimeve (SKI) në bashkëpunim të ngushtë me MFE, mbi *"Vlerësimin e ndikimit të pasojave që rrjedhin nga pandemia e COVID-19 mbi aktivitetin e biznesit në Shqipëri"*, 28 mars - 6 maj 2020. Anketa analizon përgjigjet e 833 bizneseve që operojnë në të gjithë territorin e vendit.
- (ii) Pyetësor i SKI<sup>4</sup> drejtuar të gjithë anëtarëve të KI mbi opsionet e rimëkëmbjes ekonomike me sugjerime mbi sektorët prioritarë. Qëllimi i këtyre konsultimeve ishte mbledhja e propozimeve mbi opsionet e mundshme të ndërhyrjeve për rimëkëmbjen ekonomike, të cilat adresojnë jo vetëm mbijetesën e bizneseve dhe vendeve të punës, por që ofrojnë edhe pikëpamje mbi prioritizimin e refor-

4 Shtojca 4

mave në afatmesëm dhe afatgjatë, të duhura për ekonominë shqiptare.

- (iii) Mbi bazën e rekomandimeve të mësipërme dhe në vijim të Urdhërave<sup>5</sup> të Përbashkët të Punës, gjatë muajit maj, u organizuan konsultime në nivel teknik përmes platformës ZOOM nga SKI në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), si edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Objekti i këtyre takimeve, ishte diskutimi dhe specifikimi në nivel sektorial i shtyllave kryesore të rekomandimeve sipas institucioneve dhe përcaktimi i afateve kohore.
- (iv) Hulumtimi i dokumentave, ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me masat e ndërmara për mbështetjen e ekonomisë shqiptare pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pas shpërthimit të pandemisë botërore të COVID-19. Hulumtimi i raporteve ndërkombëtare si *"European Economic Forecast"* i Komisionit Evropian, *"Western Balkan Regular Economic Report"* i Bankës Botërore (BB), *"World Economic Outlook"* FMN, OECD, UNCTAD, etj.
- (v) Hartimi i një matrice krahasuese Shqipëria, Ballkani Perëndimor dhe Kroacia mbi masat mbështetëse të lançuara nga qeveritë e këtyre vendeve në ndihmë të ekonomisë në përballje me implikimet e pandemisë së COVID-19.

5 Urdhër të Përbashkët Pune MFE, MBZHR, MEI

## KONTEKSTI

Që prej fillimit të pandemisë, institucione të rëndësishme ndërkombëtare kanë dhënë parashikimet e tyre në lidhje me ndikimin e pandemisë në rritjen ekonomike si edhe problematikat kryesore që do të hasin sidomos ekonomitë e vendeve në zhvillim në periudhën e rimëkëmbjes ekonomike. Ende nuk dihet dëmi ekonomik që i është shkaktuar ekonomisë globale nga pandemia e COVID-19, por ekziston një konsensus i gjerë mes ekonomistëve që efektet do të jenë të rënda dhe do të prekin pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Shkalla e ndikimit do të varet nga niveli i zhvillimit ekonomik, sidomos nga struktura ekonomike e vendeve dhe varësia e tyre nga shkëmbimet tregtare.

Kështu, referuar parashikimeve të FMN<sup>6</sup>, pandemia e COVID-19 po rrit në mënyrë të konsiderueshme kostot njerëzore dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e jetës po ndikojnë rëndë aktivitetin ekonomik. Si rezultat i kësaj, ekonomia

6 World Economic Outlook (prill 2020), FMN.

botërore do të tkurret me rreth 3% gjatë vitit 2020, më shumë se gjatë krizës financiare të vitit 2008/2009. Nëse pandemia do të zhduket gjatë gjysmës së dytë të vitit, duke larguar edhe masat kufizuese, e ndihmuar nga planet mbështetëse, ekonomia botërore mund ta rimarrë veten duke u rritur me 5,8% përgjatë vitit 2021. Vendet e Euro Zonës do të përjetojnë një tkurrje edhe më të madhe me rreth 7,5%. *Greqia dhe Italia, dy partnerët kryesorë të Shqipërisë në ekonomi, do të përjetojnë rënien më të thellë ekonomike në Eurozonë përgjatë vitit 2020, përkatësisht me 10% dhe 9,1% sipas parashikimeve të FMN.*

Ndërkohë, sipas parashikimeve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)<sup>7</sup>, sikurse shumica e vendeve<sup>8</sup> në botë edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor do të tkurret ekonomikisht. Shqipëria, e goditur fillimisht nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, e më pas nga pandemia e COVID-19 në mënyrë të njëpasnjëshme do të duhet të përballlet me pasojat të dyfishta. Parashikimet për rënien ekonomike të saj variojnë nga -5% sipas FMN dhe BB<sup>9</sup>, në -9%.

Në lidhje me Shqipërinë, parashikimet konsiderojnë se impakti i tërmetit (2019)<sup>10</sup>, vlerësohet

7 Regional Economic Prospects (maj 2020), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

8 Sipas World Economic Outlook, FMN, më shumë se 90% e vendeve të botës do të përjetojnë ulje ekonomike gjatë 2020.

9 World Economic Outlook (prill 2020), FMN & Regular Economic Report (pranverë 2020), BB.

10 Albania Post-Disaster Needs Assessment (shkurt 2020), përgatitur nga Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me BE, OKB dhe BB.

të ketë efekte ekuivalente me 6,4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në dëme dhe në 1,1% të PBB-së në humbje<sup>11</sup>. Për sa i përket humbjeve, sektorët ekonomikë më të goditur ishin *turizmi dhe pasuritë e paluajtshme*, por dëme të konsiderueshme u shkaktuan gjithashtu në *arsim, shëndetësi, infrastrukturë publike, prodhim, tregti dhe bujqësi*.

Theksojmë se paketa e rindërtimit prej 160 milionë Euro pritej t'i jepte një nxitje rritjes afatshkurtër të ekonomisë shqiptare, kryesisht duke dhënë një shtysë sektorit të ndërtimit dhe shpenzimeve të sektorit privat, por *përhapja e pandemisë së COVID-19 i uli pritshmëritë e rimëkëmbjes ekonomike*. Kështu, sipas raportit më të fundit të publikuar nga BB, ekonomia shqiptare do të përballet me rënie të ofertës si rezultat i ndërprerjes së zinxhirit të furnizimit global, por edhe rënie të ofertës së punës si rrjedhim i karantinës dhe masave të distancimit social. Pasiguria që shoqëron kohëzgjatjen dhe përparimin e pandemisë, mund të sjellë efekte shtesë pasi punëtorët do të humbasin të ardhurat e tyre, veçanërisht në sektorët më të prekur, si *turizmi, prodhimi dhe tregtia e produkteve jo-bazë*. Sipas të njëjtit raport të BB, vendet me rënie ekonomike më të lartë në

rajonin e Ballkanit Perëndimor do të jenë Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova. *Arsyeja kryesore do të jetë varësia e lartë e këtyre vendeve nga sektori i turizmit*.

Në përballje me dy emergjenca të njëpasnjëshme brenda një periudhe kohore të shkurtër, Qeveria Shqiptare hartoi paketat mbështetëse të ekonomisë<sup>12</sup>. Pas kalimit të fazës së parë të emergjencës të orientuar në nevojat emergjente humanitare pas tërmetit, përpjekjet u fokusuan në përgatitjen e një programi të konsoliduar rindërtimi të koordinuar midis Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve, partnerëve për zhvillim dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Theksojmë gjithashtu edhe hapjen e negociatave me BE, në vigjilje të krizës. Në vijim, Qeveria Shqiptare miratoi dy paketa financiare mbështetëse për individët dhe bizneset e prekura nga pandemia e COVID-19 të cilat konsistojnë në shpenzime buxhetore, parashikimin e garancive shtetërore dhe shtyrje të pagimit të detyrimeve tatimore për kategori të caktuara tatimpaguesish. Këto masa u shoqëruan edhe me vendimmarrje sa i takon politikës monetare dhe asaj të kreditimit të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë.

<sup>12</sup> Shtojca 1 shtjellon në mënyrë më të detajuar paketat mbështetëse të Qeverisë Shqiptare pas tërmetit dhe gjatë pandemisë së COVID-19.

<sup>11</sup> Dëmet arrijnë në 26,4% të formimit të kapitalit bruto fiks.

## GJETJE

**N**ë përputhje me sa më lart, dhe në përpjekje për të evidentuar problematikat më kryesore, dhe sugjerimet e mundshme, Sekretariati i KI në bazë të analizave të raporteve ndërkombëtare dhe të dhënave nga anketa e ndërmarrë ka evidentuar disa nga gjetjet kryesore në lidhje me impaktin e pandemisë së COVID-19 në ekonominë shqiptare.

### 1. VLERËSIME TË RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE

Në përgjithësi vlerësimet konvergojnë përsa i përket (i) *impaktit sektorial dhe punësimit*, (ii) *sfidave unike të ekonomisë shqiptare pas tërmetit të 26 nëntorit 2019*, (iii) *recensionit të pritshëm në ekonomi* e cila mbështetet kryesisht në shkëmbimet tregtare dhe investimet nga vendet evropiane. *Prodhimi dhe sektori i turizmit parashikohen*

*të preken më shumë* nga përhapja e pandemisë duke rritur edhe nivelet e papunësisë në vend. Ndërkohë edhe hapësirat fiskale për mbështetje mbeten të limituara.

Më specifiku:

*Sipas "Regular Economic Report" (pranverë 2020) të BB, ekonomia shqiptare do të:*

- Përballet me vështirësi si rezultat i shkatërrimit të vendeve të punës – Tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga vetëpunësimi dhe informaliteti i lartë dhe si rezultat ndjeshmëria e këtyre vendeve të punës ndaj pasojave të pandemisë së COVID-19 do të jetë shumë e lartë.*
- Varësia e lartë e Shqipërisë nga sektori i turizmit mund të sjellë pasoja të konsiderueshme në uljen e të ardhurave nga ky sektor si rezultat i kufizimeve në lëvizje, rrjedhojë direkte e pandemisë së COVID-19.*

3. Ndhurma e qeverive në këto momente krize është shumë e rëndësishme për ekonominë, por në Shqipëri *hapësira fiskale për sigurimin e mbështetjes së nevojshme financiare ndaj ekonomisë është shumë e pakët* nëse merren parasysh parametrat fiskale, defiçiti dhe borxhi publik.
4. Sektori financiar edhe pse me kapital solid dhe likuiditet të mjaftueshëm, sërish *do të jetë në provë në këtë situatë të paprecedentë*, duke patur parasysh se kreditë e këqija edhe pse janë ulur, sërish në Shqipëri mbeten në nivele të larta.

Sipas Raportit "European Economic Forecast" (pranverë 2020) i KE:

1. Mbështetja e lartë e ekonomisë shqiptare në bujqësinë e llojit "familjarë" dhe prodhimin hidro të energjisë *do të mund të jenë mbështetje për të minimizuar sado pak tkurrjen ekonomike si rezultat i pandemisë*, duke qënë se këto do të jenë dy sektorët më pak të prekur.
2. *Rritja e niveleve të papunësisë dhe pasiguria e programeve të mbrojtjes sociale* do të jenë kontribuesit kryesorë në uljen e konsumit të brendshëm.
3. *Përkeqësimi të balancave fiskale në vend*. Pasojat e tërmetit të nëntor 2019 të ndjekura nga ndërhyrjet qeveritare në përballje të pandemisë së COVID-19 të ndërthurura me parashikimet për ulje të të ardhurave publike do të sjellin rritje të borxhit publik dhe përkeqësim të defiçitit fiskal.

Sipas Raportit "Regional Economic Prospect" (maj 2020) të BERZH:

1. *Varësia e lartë e ekonomisë shqiptare ndaj turizmit* do të shkaktojë ulje të të ardhurave nga ky sektor duke ndikuar drejtpërdrejt rritjen ekonomike të vendit.
2. *Varësia e lartë e ekonomisë shqiptare ndaj ek-*

*sporteve të produkteve gjysëm të gatshëm me vlerë të shtuar të ulët, kryesisht me Italinë* e prekur në masë të lartë nga pandemia do të ketë efekte negative në ekonominë e vendit.

3. *Edhe pritsshmëria për rënien e remitancave në vend* si rezultat i pandemisë do të jetë një tjetër faktor që do të ndikojë uljen ekonomike në vend.

## 2. REZULTATET KRYESORE TË ANKETËS

Në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme, Sekretariati i KI në bashkëpunim të ngushtë me MFE, nisi një anketim mbi "Vlerësimin e ndikimit të pasojave që rrjedhin nga pandemia e COVID-19 mbi aktivitetin e biznesit në Shqipëri".

Anketa ishte unike për momentin (mars - maj 2020) dhe kishte për qëllim grumbullimin e perceptimeve paraprake mbi ndikimin e COVID-19 në veprimtarinë e biznesit në Shqipëri, sipas sektorëve specifikë, madhësisë së kompanive dhe numrit të të punësuarve. Më poshtë<sup>13</sup> janë pasqyruar shkurtimisht gjetjet kryesore:

- » COVID-19 ka ndikuar çdo sektor të ekonomisë shqiptare. Turizmi dhe shërbimet pritet të ndikohen maksimalisht nga pandemia. *Pothuajse gjysma e ekonomisë shqiptare ndali veprimtarinë e saj*. Ndër të gjithë sektorët ekonomikë, turizmi është më i prekuri me një mbyllje të veprimtarisë deri në 75%, ndërsa sektori i bujqësisë vazhdoi punën pjesërisht ose tërësisht në 81% të saj.
- » COVID-19 ka ulur në mënyrë të ndjeshme pritsshmëritë e kompanive për qarkullimin vjetor, të cilat në masën më të madhe presin më shumë se 20 përqind zvogëlim të tij.
- » *Pandemia i ka përballur kompanitë me sfida të*

<sup>13</sup> Rezultatet e plota të anketës do të publikohen së shpejti në faqen e Këshillit të Investimeve.

*jashtëzakonshme ku prioritizojmë* mungesën e klientëve, të likuiditetit, vështirësi në pagesën e pagave dhe respektimin e detyrimeve tatimore. Problematika janë hasur edhe nga importet kryesisht me vendet e BE-së. Industria rezultoi të jetë sektori më i varur nga importet, ndërsa ndërtimi, sektori më pak i varur. *Vetëm 2% e ndërmarrjeve që operojnë kryesisht në tregti, industri dhe shërbime deklarojnë se mund të zhvendosen plotësisht nga importet në burimet e vendit për të siguruar vazhdimësinë e biznesit*.

- » *Për shkak të pandemisë së COVID-19, rutina klasike e paraqitjes në punë ndryshoi në mënyrë dramatike dhe bizneset nuk ishin të përgatitura se si të reagonin*. Kështu, 37% e kompanive nuk morën asnjë masë për të adresuar pamundësinë e punonjësve për t'u paraqitur në vendin e punës, ndërsa pjesa tjetër e kompanive përdorën punën online, shfrytëzimin e lejes vjetore apo edhe largimet nga puna.
- » COVID-19 u kthye në kërcënim për vijimësinë e bizneseve. *Pavarësisht sektorit apo madhësisë, bizneset vlerësojnë se ndikimi i COVID-19 në ekonomi do të zgjasë deri në një vit*. Në përpjekje për të siguruar vijimësinë e biznesit të tyre, pjesa më e madhe e kompanive deklaroi se do të përdorin të ardhurat e akumuluar, dhe mundësinë e uljes së kostove, kryesisht duke pushuar nga puna punonjësit apo duke ulur prodhimin, etj.
- » Një nga gjetjet e rëndësishme, është se *COVID-19 vërtetoi se mbështetja e qeverisë dhe bashkëpunimi janë të pazëvendësueshëm në përballimin e situatave të panjohura për të siguruar vazhdimësinë e biznesit*. Plani financiar i lançuar nga qeveria shqiptare u mirëprit nga kompanitë si një mundësi për të siguruar vijimësinë e tyre. Kështu, kompanitë me xhiro

mbi 14 milionë lekë vlerësuan se shtyrja e pagesës së kredisë do të ketë ndikimin më pozitiv; ndërkohë biznesi me xhiro deri në 14 milionë ALL vlerëson se mbështetja financiare për punonjësit do të ketë një ndikim lehtësues për ta.

- » *COVID-19 ndërgjigjësoi kompanitë për efikasitetin e përdorimit të shërbimeve online*. 75% e kompanive deklaruan se i përdorën shërbimet online, dhe më tej 81% e tyre deklaruan se do të vazhdojnë të përdorin shërbimet online në të ardhmen. *Interesant është fakti se 38% e kompanive deklaruan se do të ndryshonin planet e tyre të investimit drejt shërbimeve online, kryesisht duke investuar në teknologji të reja, pavarësisht madhësisë së tyre*. Mbetet për t'u analizuar dhe specifikuar në të ardhmen se cilat shërbime online janë më të rëndësishme për biznesin.
- » *COVID-19 nxorri në pah faktin që kompanitë shqiptare janë seriozisht të papërgatitura për të përballuar situata të paparashikuara*. 86% e kompanive deklaruan se nuk kanë plan të miratuar emergjence, pavarësisht nga madhësia apo sektori ekonomik.

## 3. NDËRHYRJET NË EKONOMI NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE KROACI

Në një vështrim krahasues me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe Kroacinë<sup>14</sup> rezultoi se shtyllat kryesore të masave mbështetëse nga ana e qeverive janë: (1) *masat dhe ndërhyrjet fiskale*; (2) *mbrojtja e punësimit*; (3) *masat mbështetëse financiare/monetare* dhe (4) *masat sektoriale*.

*Ndërhyrjet fiskale* - pothuajse të gjitha qeveritë kanë qenë aktive duke siguruar masa që mbështesin drejtpërdrejt sipërmarrjet përmes

<sup>14</sup> Për më shumë detaje rreth paketave mbështetëse sipas vendeve referoju Shtojcës 2

shtyrjes së afatit të pagimit të taksave dhe tati-meve (shtyrja e taksave, kontributet e kujdesit shoqëror/shëndetësor, parapagimet e tatim-fitimit, etj.) Këto janë masa të pastra fiskale që janë marrë nga pothuajse të gjitha vendet e BP sipas specifikave të ndryshme.

*Mbrojtja e punësimit* - shtylla e dytë e masave është orientuar në subvencionet për paga që kanë për qëllim ruajtjen e vendeve të punës. Mekanizmat e përdorur janë ndihmë direkte për kategoritë e punonjësve, subvencionimi i kontributeve për sipërmarrjet, rritja e pagave në sektorin e shëndetësisë, etj. Fokusi kryesor në masat sipas shtyllës (1) dhe (2) janë bizneset e vogla dhe të vetëpunësuarit.

*Masat financiare/monetare* - masat në këtë shtyllë

mund të grupohen në 2 kategori: (1) garantimi i likuiditetit (nëpërmjet Garancive Shtetërore) dhe (2) masat për lehtësimin e barrës së kredive aktuale të biznesit (nëpërmjet lehtësimit të procedurave dhe shtyrjes së pagesës së kësteve).

*Masat sektoriale* - Kroacia duket se ka mbështetur një qasje sektoriale përmes një grupi masash për bujqësinë. Kjo është e lidhur me skemat/fondet e BE-së në dispozicion vetëm të vendeve të BE-së. Ndërkohë, qeveria në Kroaci u orientua në blerjen e stokut të mallrave të gatshme në bujqësi, industri dhe agro-përpunim<sup>15</sup>. Mbështetje për bujqësinë ka ofruar edhe Maqedonia e Veriut e cila i ka dedikuar paketën e tretë të masave anti COVID-19 mbështetjes për bujqësinë, përmes mobilizimit të 76,1 milionë EUR<sup>16</sup>.

<sup>15</sup> Komisioni Evropian miratoi një skemë (afërsisht 4 milionë €) për të mbështetur sektorin e peshkimit dhe akuakulturës në Kroaci. Skema u miratua në kuadrin e Kuadrin të Përkohshëm të Ndihmës Shtetërore të miratuar nga Komisioni më 19 mars 2020, i ndryshuar më 3 prill 2020.

<sup>16</sup> Këtu përfshihen a) mbështetje për sipërmarrjet mikro dhe SME-të; b) mbështetje të drejtpërdrejt për fermerët e vajit jeshil ku përfshihen rreth 50.000 fermerë me një vlerë prej EUR 4,6 milionë; c) Mbështetje përpunuesve të rrushit dhe vreshtave me një vlerë prej EUR 3,5 milionë për një periudhë tre-vjeçare për të stimuluar prodhimin e dizinfektantëve alkolikë; d) kreditim afatgjatë për kullotat në mbështetje të blegtorëve; e) Program financimi për kompanitë mikro-bujqësore me vlerë EUR 3 milionë për pajisje përpunimi dhe marketim.

## SUGJERIME DHE REKOMANDIME

**N**ë kontekstin edhe të analizave dhe sugjerimeve të mëparshme të KI në këto 5 vite, vlen të nënvizohen elementët e mëposhtëm të cilët do të mund të krijojnë një *momentum pozitiv* dhe një paketë konkurruese edhe në raport me vendet e rajonit sikurse kërkohet veçanërisht nga shoqatat dhe dhomat e biznesit, si edhe do të konvergohin me ambicjet për miratimin e ligjit të unifikuar të investimeve brenda vitit 2020.

- » Rëndësia e formalizimit të ekonomisë (analizuar nga KI që prej 2015), si një sfidë e rëndësishme për vendin dhe veçanërisht për sektorë si turizëm, bujqësi, shërbime, etj., në të cilat informaliteti shfaq tipologji specike dhe është faktor thelbësor që kërcënon konkurrencën e ndershme. *Krizat e njëpasnjëshme që lidhen me situatat e krijuara në vend pas tërmetit dhe gjatë Covid-19 krijojnë premisa për rritjen e informalitetit* por ndërkohë edhe vështirësojnë dhënien e ndihmës së qeverisë në kohë për përfituesit.
- » Stabilizimin e kuadrin ligjor dhe nënligjor

fiskal<sup>17</sup>. Ndryshimet e shpeshta përgjatë këtyre viteve, edhe pse në shumicën e rasteve kanë konsistuar në parashikimin e incentivave dhe masave lehtësuese për kategori të caktuara tatimpaguesish, kanë krijuar shumë përjashtime dhe fragmentime tatimore, rregulla dhe kritere specifike të zbatueshme sipas kategorive të tatimpaguesve, të cilat nëse nuk mirë-administrohen mund të krijojnë efektin e kundër dëshiruar sa i përket formalizimit të ekonomisë.

Mirëadministrimi i tyre në afatshkurtër kërkon:

- » dedikimin e burimeve shtesë, një administratë efikase, e shpejtë, joburokratike dhe e përgjegjshme;
- » transparencë të incentivave sektoriale të zbatueshme për investitorët dhe palët e interesuara nëpërmjet përgatitjes së një inventari sistematik (të përditësuar në mënyrë periodike).

<sup>17</sup> Këtu bëhet fjalë veçanërisht për procedurat tatimore dhe udhëzimet përkatëse të cilat janë ndryshuar më shumë se 17 herë sa herë që është parë e nevojshme të adresohet një problematikë ad-hoc dhe jo në mënyrë integrale duke krijuar mospërputhje në disa raste midis ligjit dhe udhëzimeve.

Ndërsa në një kontekst afatmesëm, sugjerohet rishikimi themelor i ligjeve të tilla si Ligji 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, Ligji 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe veçanërisht Ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i cili ka qenë edhe më herët objekt diskutimi dhe nuk reflekton si duhet kontekstin ekonomik të biznesit dhe të individëve.

Theksojmë se përgatitja e ligjeve të reja në këto fusha do të mundësonte së pari një sistem tatimor të përgjegjshëm kundrejt nevojave që ka ekonomia për formalizimin e ndërmarrjeve dhe të individit. Nga ana tjetër ato do të mundësonin: (i) një koherencë më të madhe të tyre me kërkesat e biznesit dhe procedurat e dëshiruara nga sipërmarrja; (ii) shmangien e mospërputhjeve ekzistuese me legjislacionin e tyre sekondar i cili vështirëson zbatimin e duhur në praktikë; (iii) thjeshtimin e mëtejshëm të procedurave biznes-administratë në dritën e reformës së fiskalizimit që pritet të zbatohet nga muaji shtator dhe zhvillimeve teknologjike; (iv) si edhe do t'i hapte rrugë reformës në fushën e tatimit të të ardhurave duke vendosur barazinë dhe drejtësinë e sistemit fiskal në themel të tatimit të të ardhurave të individëve dhe korporatave, sa i takon: njohjes së shpenzimeve të zbritshme në favor të individëve, fashave të të ardhurave dhe mënyrës së tatimit të tyre, zgjerimit të afatit për mbartjen e humbjeve tatimore për bizneset nga 3 vjet në 5-7 vjet duke mbështetur investimet e reja “greenfield” pavarësisht shumës fillestare të investimit.

## 1. SUGJERIME TË ANËTARËVE DHE PARTNERËVE<sup>18</sup> TË KI

Gjatë periudhës prill – maj 2020, Sekretariati i KI gjatë një komunikimi të strukturuar dhe intensiv me anëtarët e KI, evidentoi sugjerimet e tyre për masat që duhen ndërmarrë në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas COVID-19.

Bazuar në analizën e Sekretariatit, ndërhyrjet e propozuara prej tyre konvergojnë në fushat e mëposhtme:

### a. Hartimi i një politike inkurajuese për tërheqjen e investimeve të huaja “Albania-The Gateway to Balkan”, e cila të ketë në fokus:

- » *Ndërtimin e strategjisë së Marketingut “Albania-The Gateway to Balkan” (Dhoma Kombëtare e Diasporës) dhe i një pakete konkrete dhe efektive për nxitjen e investimeve të huaja, mundësisht më tërheqëse se vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (BALFIN). Për këtë, duhet formalizuar një paketë progresive incentivash për përsheptimin e investimeve të qëndrueshme dhe afatgjata, e koordinuar edhe me organizatat ndërkombëtare.* Incentivim fiskal përmes lehtësimit nga taksat për një periudhë 5-vjeçare mund të bëhet bazuar në disa elementë si p.sh. investim me vlerë mbi \$1 Mil dhe që gjeneron mbi 50 vende të reja pune gjatë 2020-2021 (AMCHAM).
- » *Objektet industriale të paprivatizuara - Hartimi i një liste me të gjitha objektet industriale që nuk janë privatizuar ende, ku të shikohet mundësia e përthithjes së investitorëve të huaj. Të krijohen kushtet pranë këtyre objekteve (shumica janë pothuaj të rrënuar), të*

<sup>18</sup> Këto sugjerime do konsultohen me specifikisht në muajt në vijim me përfaqësues të qeverisë në mënyrë që të analizohet mundësia e adoptimit të tyre në politika e plane veprimi.

garantohet infrastrukturë e domosdoshme me rrugë, energji, ujë të pijshëm, transport si dhe të garantohet promovimi i objekteve industriale, incentivave të ndryshme për investitorët e huaj dhe për sektorët me interes duke bashkëpunuar me shoqatat e biznesit, AIDA, etj. (CONFINDUSTRIA).

- » *Zonat me potencial njerëzor - Hartimi i një plani nxitës për tërheqjen e investimeve të reja në ato zona ku ka potencial njerëzor, por mungojnë vendet e punës.* Nxitja për tërheqjen e investimeve mund të bëhet përmes mbulimit të një pjese të shpenzimeve të transportit drejt këtyre zonave, eliminimit të taksave vendore për bizneset e reja nëpër zonat ku papunësia është e lartë, mbulimit të kostove të trajnimit për punonjësit (CONFINDUSTRIA).
- » *Thjeshtëzimin e procedurave. Shkurtimi i procedurave të investimit referuar hapave dhe kohës deri në finalizimin e investimit, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë në rajon (AMCHAM).*
- » *Koordinimin me diasporën dhe transparencë e planeve të investimeve publike. Të konsiderohen politika inkurajimi për investimet nga diaspora të koordinuara me investimet publike (Dhoma Kombëtare e Diasporës).*
- » *Duhet të rritet integrimi ekonomik i vendit me pjesën tjetër të botës duke u bërë pjesë e zinxhirit të furnizimeve, duke mundësuar zgjerimin e ofrimit të shërbimeve e mallrave. Kjo kërkon investime publike më të mëdha dhe më të mirë-menaxhuara. Ndërkohë, kapacitetet e energjisë duhet të rriten kryesisht përmes investimeve në burime të rinovueshme duke ulur varësinë ekskluzive të ekonomisë nga hidrocentralet (BERZH).*
- » *Përmirësimin e qeverisjes me fokus zgjidhjen e problematikave mbi korrupsionin, pronën*

dhe sektorin privat. Qeverisja korporative dhe ajo publike duhet të përmirësohet në mënyrë që të përmirësohet mjedisi i të bërit biznes, duke ulur korrupsionin, lehtësuar aksesin në pronësi dhe duke kontribuar kështu në më shumë investime të sektorit privat (BERZH).

- » *Zgjidhja e problematikës së pronësisë mbi tokën. Përsheptimi i zgjidhjes së problematikave të pronësisë në zonat prioritare. Është momenti për të ofruar më shumë se sa vetëm skemën “1 Euro-godina e amortizuar”. Lidhur me këtë aspekt vlen për t'u përmendur gjithashtu se nevojitet ndërhyrje në regjistrimin kadastral të pronës, pasi aktualisht ekzistojnë sipërfaqe të mëdha tokash që nuk kanë regjistrim fillestar. Duhet priorizuar regjistrimi në mënyrë të tillë që t'i shërbejë turizmit. Inventarizimi i pronave shtetërore, krijimi i pasaportave të këtyre pronave do të lehtësonte procesin e vënies në dispozicion të pronave shtetërore kundrejt investitorëve (AIDA, BERZH).*

### b. Konkurrueshmëri e produkteve shqiptare në tregjet globale

- » *Incentivimi i eksporteve dhe produkteve “Made in Albania” përmes një pakete inkurajuese ligjore për sipërmarrjet që mund të jenë konkurruese në tregje globale (si industria e lehtë përpunuese, fasoneritë - tekstile, këpucë), përmes subvencionimeve të këtyre sektorëve.*
- » *Nxitja e një bashkëpunimi të shpejtë ekonomik me Kosovën (mund të konsiderohet edhe ofrimi i shtetësisë shqiptarëve të Kosovës (FIAA).*
- » *Duhet promovuar Shqipërinë si një destinacion tërheqës për investime dhe industri përpunuese, mjaft afër tregjeve të vendeve të BE,*



për të konkurruar Kinën apo vendet e tjera Aziatike (FIAA). Kapacitetet përpunuese të Shqipërisë janë të panjohura për tregun e huaj që aktualisht po kërkon diversifikim të zinxhirit të furnizimit, ndaj kompanitë shqiptare duhen incentivuar për t'u ekspozuar më shumë globalisht, përmes asistencës me faqet e internetit, marketing, pjesëmarrje në panairë ndërkombëtarë (AMCHAM).

- » *Mbështetje në drejtim të rritjes së kapaciteteve përpunuese dhe të standartizimit të kontrollit të cilësisë* sipas normativave evropiane, për të rritur eksportin e produkteve tradicionale dhe të atyre bio apo natyrale (CONFINDUSTRIA). *Subvencionim në certifikim dhe konsulencë të produkteve të destinuara për tregun e BE*, veçanërisht ato ushqimore (laboratorë për certifikim të produkteve bio) (DIHA).
- » *Nxitja e eksporteve shqiptare në industrinë e lehtë*, duke ulur barrierat doganore në importin e lëndës së parë. Rasti konkret, në janar 2019 u vendos tarifë doganore për produktet plastike (DIHA).
- » *Krijimi i një fondi prej 100 milionë EUR për mbështetjen e kompanive me potenciale investimi dhe tregu për eksport*. Ky fond në formë granti deri në 20.000 EUR për kompani, t'u ofrohet për implementimin e standardeve, certifikimin e produkteve dhe shërbimeve, për rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe punësimit, për marketingun, inovacionin, për trajnime, dixhitalizimin, etj., që do të përbëjnë bazën e kritereve të përfitimit të këtij granti nga kompanitë (DHTI).
- » *Biznesi eksportues, duhet ndihmuar të mbyllë ciklin e plotë të prodhimit në vend* (AIDA).
- » *Krijimi i lidhjeve midis NVM-ve dhe instituteve të teknologjisë dhe institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit* (AIDA).
- » *Me qëllim zhvillimin e zonave të varfëra apo më pak të zhvilluara duhet që të ulen taksat, tatumet, ose të orientohen politikat subvencionuese*

- fondet e ndryshme si IPARD apo të tjera. (1) Ri-formulim të skemave grant për biznesin; (2) Ulje të barrës fiskale për disa sektorë; (3) Duhet vënë në funksionim zonat e lira apo TEDA, duke rishikuar ndërkohë edhe incentivat e TEDA-ve (AIDA).

### c. Informaliteti

- » *Duhet ndërtuar një strategji afatgjatë për uljen e informalitetit* në mënyrë që të shmangët konkurrenca e pandershme dhe të fokusohemi në pagesat elektronike si një mënyrë për të shmangur varësinë nga paraja në dorë dhe njëkohësisht të ulet informaliteti (AMCHAM/Dhoma Kombëtare e Diasporës/BALFIN).
- » *Të sigurohet transparencja dhe qëndrueshmëria ndaj masave të ndërmarrja në ndihmë të sektorit privat*, në veçanti NVM; minimizimi i ekonomisë informale duke përdorur incentivat për formalizim (BE).
- » *Informaliteti është një nga çështjet kryesore që redukton të ardhurat publike dhe kontribuon në investime të ulëta* (BERZH).

### d. Ndërmarrja e politikave aktive pas COVID-19 me fokus trajnimin e fuqisë punëtore si faktor i rëndësishëm për nxitjen e investimeve të qëndrueshme

- » *Harmonizimi në kohë midis nevojave për fuqi punëtore në sektorët më prioritarë me masat stimuluuese për orientimin e edukimit profesional të të rinjve dhe trajnimin e forcës punëtore*, pasi ka mangësi në sasi dhe cilësi të forcave të punës (CONFINDUSTRIA ALBANIA/AMCHAM/BERZH/BB/AIDA).
- » *Të krijohen politika për kthimin në atdhe të profesionistëve shqiptarë* nga jashtë Shqipërisë (AMCHAM).
- » *Organizimi i trajnimeve në kurse 1-javore – 3-mujore për punonjësit e sektorit të agrobiznesit* (Agrotek shpk).
- » *Incentivimi i edukimit profesional*

*shumëgjuesh* dhe në kujdesin shëndetësor si mjekësi/infermieri (FIAA).

- » *Marrja e masave afatshkurtra për ruajtjen e normës së punësimit duke përdorur skema të punësimit afatshkurtra*; dhe sapo të kalojë pandemia COVID-19, të ndërmerren politika aktive mbi tregun e punës, me fokus të veçantë trajnimin/rritjen e aftësive (BE).
- » *Politika për të rritur njohuritë e aftësive sipërmarrëse dhe më specifikesht financiare*. *Ndërmarrja e politikave në mbështetje të shërbimeve mbështetëse për investimet dhe eksportet të cilat do të përmirësojnë nivelet shumë të ulta të aftësive sipërmarrëse dhe njohurive financiare (BE) dhe Mbështetje financiare për kompanitë që të bashkëpunojnë me kompani trajnimesh dhe të zhvillojnë programe trajnimi për punonjësit*. Gjithashtu, mbështetje financiare që të formalizohet punësimi dhe të rritet siguria në punë (BERZH).

### e. Sfida e likuiditetit dhe opsionet e mbështetjes

- » *Mundësimi i kredive të subvencionuara për kompanitë e eksportit* me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre eksportuese (AMCHAM).
- » *Krijimi i një fondi garancie për kreditimin e sektorëve ekonomik prioritarë* prej 500 milionë EUR, të ngritur me kontributin e qeverisë dhe donatorëve për lehtësimin e aksesit për kredi për bizneset që operojnë në sektorin e turizmit, industrive prodhuese, bujqësisë, shërbimeve, transportit dhe specifikesht për gratë sipërmarrëse, etj. Fondi i garancisë, në veprim deri në 5 vjet, do të krijojë kushte lehtësuese kreditimi, për një periudhë mospagimi deri në 1 vit, me interesa 0-1% (DHTI).
- » *Emetimi i obligacioneve për kompanitë e mëdha/korporatat* do të siguronte burime monetare të konsiderueshme. Në kushtet e krizës të shikohet mundësia që të sigurohet një kosto më e ulët e interesit të tyre duke

aplikuar ulje të taksave për maturime mbi 5-vjeçare (DHTI).

- » *Të incentivohen bizneset që i drejtohen tregut të kapitaleve për të kërkuar fonde duke u listuar në bursë*. Një stimul i tillë do të shkarkonte nga Qeveria presionin e biznesit për fonde, dhe do i orientonte ata drejt mekanizmit të tregut, nëpërmjet shitjes së aksioneve apo obligacioneve korporative të huamarrjes. Incentivat mund të jenë ligjore (me detyrim siç ka ndodhur edhe në disa vende të rajonit) apo mund të jenë incentive fiskale (ulje e tatumit fitimit për 3-5 vite). Një masë e tillë, do të luftonte evazionin fiskal, do t'u mundësonte bizneseve aksesimin e fondeve afatgjata, dhe do të zhvillonte tregun e kapitaleve (DHTI).
- » *Krijimin e një banke zhvillimi me kapital të injektuar nga qeveria apo edhe investime të tjera përfshirë edhe masën monetare të përfutur prej aplikimit të një amnistie të plotë të parasë*. Kjo bankë mund të kreditojë bizneset në sektorët prioritarë, duke blerë obligacione korporate, ose duke garantuar emetimin e këtyre obligacioneve nga biznesi. Qëllimi do të jetë drejtimi i ekonomisë dhe financimi i sektorëve strategjikë (DHTI).
- » *Amnisti totale të parasë së padëklaruar* për një periudhë të caktuar për shtetasit shqiptarë. Kushti për pranimin e amnistisë do të jetë përdorimi i parasë që do të legalizohet në obligacione qeveritare dhe në bankën e zhvillimit, sipas kushteve të përcaktuara në propozimet përkatëse. Qëllimi i amnistisë është sigurimi i financimeve publike me një kosto të ulët për t'u përballur me emergjencën si dhe sigurimi i fondeve për ringritjen ekonomike. Mbi biznesin, mund të aplikohet për gjendjet e padëklaruar të magazinës një kosto reth 15% e vlerës së deklaruar, për gjendjet e tjera që lidhen me arkën, kredinë dhe kapitalin një kosto rreth 7%; ndërsa për individin ky penalitet mund të jetë 20%-30% (DHTI).

- » *T'u mundësohet bizneseve, rristurimi i të gjitha kredive* në bazë të kërkesave për një kohëzgjatje deri në 5 vjet pa penalitete dhe pa rritje të normave të interesit për kreditë e bizneseve dhe individëve (*UCCIAL*).
- » *Dhënia fund e pengesave ligjore për ekzekutimin e kolateralit në kreditë e këqija*, duke patur parasysh riskun e rritjes së këtyre kredive në periudhën e COVID-19 (*DBE*).
- » *Do të jetë e dobishme për eksportuesit dhe firmat e integruara në zinxhirët e furnizimit të përfundim të gjithashtu nga mekanizmat e përshtatshëm të financimit të eksportit, faktorizimit dhe mekanizmave të sigurimit të kredisë*. Linjat shtesë të kredisë mund të ndihmojnë në zbutjen e rezultateve ekonomike dhe përmirësimin e aksesit në financim. Zhvlerësimi i përshpejtuar i investimeve kapitale (*BB*).
- » *Ndërtimi i një politike fiskale ekspansioniste që shënjestron zgjerimin e industrive ekzistuese përmes aktivizimit të produkteve të përshtatura bankare, në vend të atyre gjeneraliste dhe që kanë pak probabilitet të përdoren praktikisht*. Për këtë duhet përcaktuar saktë qëllimi i instrumentit, përshtatshmëria e tij me mungesën që synon të plotësojë dhe shkalla e pritjes e përdorimit. Në të kundërt, instrumenti nuk sjell asnjë vlerë të shtuar për përmirësimin e aksesit në financim të bizneseve në nevojë dhe të përshtatshme për këtë akses (*BSH*).

#### **f. Reformë fiskale me fokus konkurrueshmërinë, stabilitetin, futjen e kapitaleve, transparencën në përdorimin e fondeve publike**

- » *Hartimi i një reforme fiskale që nxit konkurrueshmërinë e fokusuar në a) uljen e taksave që të bëheni më konkurrentë se vendet e tjera të rajonit; b) kjo masë të zgjasë të paktën 5 vite në mënyrë që bizneset të planifikojnë investimet afatgjata; c) normë më e ulët taksimi për investimet strategjike*. Mënyra të tjera mund

të jenë inkurajimi i taksapaguesve që parapaguajnë taksat vjetore me zbritjen e një % të caktuar të taksës. Gjithashtu duhen konsideruar shpenzime të zbritshme, ato të donacioneve me përfitim publik, shkolla, spitale, etj. (*AMCHAM/DIHA/Dhoma Kombëtare e Diasporës*).

- » *Adoptimi sa më shpejt i strategjisë afatmesme të të ardhurave, me fokus të vecantë "shpenzimet tatimore"; vendosja e limiteve kohore për masat lehtësuese ndaj pagesës së taksave dhe tatimeve për periudhën COVID-19 si edhe rimbursimi në kohë i TVSH (*DBE*).*
- » *Procedura transparente për vlerësimin dhe miratimin e të gjitha investimeve që përfshijnë fonde publike; forcimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin dhe vlerësimin e riskut fiskal të PPP, kontratave koncesionare dhe kompanive shtetësore (*DBE*).*
- » *Orientimi i mbështetjes fiskale nga masat emergjente drejt programeve të përkohshme të krijimit të vendeve të punës: a) Lehtësimi i pjesëmarrjes së NVM-ve në prokurimet publike; b) Punët publike me theks në NVM-të; c) Ndërtimi i programeve mbështetëse të NVM-ve të përqendruara në promovimin e rritjes së produktivitetit; d) Aplikimi i zbritjeve tatimore deri në 80% të shpenzimeve në këto fusha deri në një kufi maksimal (kufiri mund të jetë për një firmë bazuar në qarkullimin/punonjësit) (*BB*).*
- » *Hartimi dhe aplikimi i një sistemi taksimi të shkallëzuar mbi pasurinë dhe vlerën e bilancit (*BSH*).*
- » *Rishikimi tërësor i realizimit të performancës për të gjitha marrëveshjet koncesionare për pasuritë kombëtare të dhëna me koncesion. Verifikime të hollësishme të realizimit apo jo të kushteve të planit të biznesit të propozuar. Verifikime për hapësirat ekzistuese për përmirësim në drejtim të shtimit të vendeve të punës dhe të rritjes së përfitimit publik (*CONFINDUSTRIA ALBANIA*).*

#### **g. Një kuadër ligjor që të garantojë sigurinë për investitorët, të garantojë konkurrueshmërinë e ndershme dhe stimulojë inovacionin - parakushte për çdo reformë të mëposhme në nivel sektorial**

- » *Përshpejtimi i Reformës në Drejtësi* me qëllim që të garantohet siguria e investitorëve të huaj dhe zbatueshmëria e kontratave. Implementimi i akteve legjislative për të shmangur monopole dhe për të inkurajuar kompanitë e huaja të tenderojnë në tregjet shqiptare (*AMCHAM*).
- » *Përmirësimi i legjislacionit mbi prokurimet publike* që të garantojë konkurrueshmërinë e ndershme, të luftojë korrupsionin dhe të garantojë praktika të ndershme konkurrueshmërie (*AMCHAM*).
- » *Përmirësimi i kuadrit ligjor e institucional në mbështetje të inovacionit*, përfshirë cilësinë, infrastrukturën dhe certifikimet me qëllim final rritjen e kapaciteteve të kompanive për eksporte (*BB*).
- » *Ligji i falimentit, pavarësisht përmirësimeve akoma ka terma të papërcaktuara qartë të cilat lënë hapësirë për keqinterpretime mes kreditorëve, gjykatave dhe administratorëve të bizneseve*. Për më tepër është e nevojshme që ky ligj të shoqërohet me aktet nënligjore, rregullore e manuale implementimi sa më parë. Administratorët e falimentit duhet të përzgjidhen në bazë meritokracie dhe të trajtohen rigorozisht (*BKT*).

#### **h. Të ndryshme**

- » *Krijimi i një grupi ekspertësh për të hartuar strategjinë e rimëkëmbjes si edhe një agjencie që do të kontrollojë tregun e brendshëm dhe zbatimin e rregullave të lojës që do rrjedhin nga strategjia e rimëkëmbjes (*Dhoma Kombëtare e Diasporës*).*
- » *Të rishikohet mundësia që në 3-5 vitet e ardhshme të reduktohet numri i të punësuarve në*

*administratën publike*, në bazë të performacës së matshme të punës që ata kryejnë duke qenë se (a) realisht është shumë i fryrë; (b) paguajnë afërsisht 1,5 paga për një vend pune për shkak të pushimeve të padrejta nga puna; (c) duke ditur që tani kemi shumë shërbime që jepen online (*CONFINDUSTRIA ALBANIA*).

- » *Përmirësimi i mjaftueshmërisë së asistencës sociale dhe marrja e masave efektive ndaj shtimit të shërbimeve sociale nëpërmjet përmirësimit të aftësive të bashkive në identifikimin e nevojave për shërbime sociale dhe përgatitjes së planeve të përkujdesit social (*DBE*).*
- » *Rritja e kapaciteteve institucionale në kërkim & zhvillim; rritja e shpenzimeve publike dhe politikave mbështetëse (*DBE*).*

#### **2. REKOMANDIME ME FOKUS SEKTORIAL**

Bazuar në sugjerimet e anketës, anëtarëve të KI, vlerësimet e raporteve të mësipërme dhe konsultimet me disa institucione përgjegjëse në kuadrin e grupeve të punës për politikat sektoriale në kuadrin e rimëkëmbjes, sugjerojmë që ndërhyrjet nga pikëpamja sektoriale të prioritetizohen si më poshtë vijon:

##### **a. Sektori i Agro-përpunimit:**

1. Për të optimizuar potencialin që ekziston në sektorin e bujqësisë, agro-përpunimit (shifra në rritje të eksporteve të fruta/perime, bimë medicinale, etj.) si edhe agro-turizimit, të përgatitet një studim i thelluar me synim dhënien e rekomandimeve specifike që stimulojnë prodhimin vendas me objektivi "zëvendësimin e importit". Më specifikisht, produkti i studimit do të jetë: *evidentim i të paktën 3 produkteve specifike që prodhohen dhe kanë potencial për t'u përpunuar në vend në të gjitha fazat e zinxhirit, dhe ndoshta edhe për t'u branduar si markë shqiptare dhe eksportuar në tregjet globale (Afat shkurtër)*. Për

këtë, brenda grupit teknik të punës MFE & MBZHR të punohet me ekspertë dhe të analizohen si më poshtë:

- a. trendi në vite i eksporteve, të dhënat mbi investimet e AZHBR, përjashtimet nga doganat për makineri dhe pajisje, mbështetjet e sektorit nga IPARD, skemat kombëtare, skemat lokale, fondet e AIDA-s, etj.
  - b. inventar i projekteve (përfshirë edhe format e mbështetjes si p.sh. garancitë, etj.) dhe studimeve në këtë drejtim si edhe fondet e dhëna nga qeveria (qendore dhe lokale) dhe donatorët.
  - c. të jepen në mënyrë grafike dhe transparente hapat që duhet të ndiqen duke filluar nga prodhimi, transporti, grumbullimi dhe futja në treg e produktve si dhe strukturat përgjegjëse.
  - d. lista e procedurave thjeshtësisht të aksesueshme nga një investitor vendas apo i huaj i interesuar për të investuar në agro-përpunim apo prodhim.
  - e. Informacioni i përshtatur për këto produkte në lidhje me sigurinë ushqimore dhe aksesin për certifikimet si GAP (veçanërisht për produktet bio apo organike).
  - f. potenciali në lidhje me stimulimin e përpunimit vendas, përfshirë edhe produktet blegtorale dhe peshkimin nëpërmjet TEDA-s, për të kaluar në prodhim industrial si edhe investime në dhoma frigoriferike, për të optimizuar zinxhirin, etj.
  - g. çdo informacion tjetër relevant për arritjen e objektivit të grupit të punës.
2. *Subvencionimi i naftës për fermerin.* Përgatitja e një analize kosto – përfitim për buxhetin e shtetit dhe fermerin, në lidhje me subvencionimin e çmimit të naftës. Argumenti për mbështetje në këtë drejtim

lidhet me (i) përdorimin e këtij instrumenti për të nxitur formalizimin e fermerëve, (ii) mbështetjen e investimeve të fermerëve, (iii) shembulli i peshkimit ku përdorimi i këtij instrumenti ka dhënë rezultate në formalizimin dhe rritjen e përpunimit të peshkut dhe nga ana tjetër kostot në buxhet kanë qënë minimale, (iv) pothuajse të gjitha vendet e rajonit e replikojnë një instrument të tillë (*Afatshkurtër*).

3. Përditësimi dhe transparencja në kohë në lidhje me *përfundimin e hartës së tokës bujqësore dhe qartësimin e pronësisë* në zonat me potencial ekonomik më të madh, aty ku prodhimi dhe impakti është më i madh, p.sh. Fieri, Lushnja si edhe juglindja e vendit, zona e Korçës (*ASHK/MBZHR, Afatmesëm*)
4. Referuar kërkesave mjaft rigorozë që skemat IPARD kanë, problematike mbetet *klasifikimi i të gjitha fermave* për të përfituar nga ato, ndaj negocimi nga ana e institucioneve përgjegjëse për përfshirjen e të gjithë fermerëve tek këto skema mbetet sfidë dhe detyrë për t'u ndjekur me prioritet tek negociatat për IPARD3 (*MBZHR, Afatgjatë*)
5. Monitorim dhe koordinim institucional mes MBZHR, DPD dhe mbikëqyrje e farmacive bujqësore në drejtim të *kufizimit të përdorimit të pakontrolluar e të rrezikshëm të pesticideve* dhe për të frenuar njëkohësisht informalitetin (*Afatshkurtër*).
6. Analizim i formave të organizimit të fermerëve që të mund t'u lehtësohet *aksesi në financim* disa kategorive. BSH dhe përfaqësues nga partnerë ndërkombëtarë për zhvillim, MFE dhe MBZHR të analizojnë problematikat për të rritur portofolin e kreditë në këtë sektor dhe të konsiderojnë politikën e kreditimit si dhe të gjenden forma inovative financimi për këtë sektor që konsiderohet me risk (*Afatmesëm*).

## b. TIK & Inovacion – momentum për "Albania Digital Solidarity Initiative"

Shqipëria konsiderohet si një vend i përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e shoqërisë së informacionit dhe mediave audiovizive, sipas Raportit të KE (maj 2019), Kapitulli 10.

COVID-19 evidentoi nevojën për diversifikimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve dhe nxori në pah edhe problematikën e mungesave së planeve të emergjencave nga ana e bizneseve, ndaj në situatën post COVID-19, anëtarët e KI vlerësojnë të nevojshme investimet në këtë sektor që ndërlidhet dhe ndikon konsiderueshëm edhe sektorët e tjerë prioritarë.

*Për maksimizimin e potencialeve të investimeve në TIK dhe Inovacion, sugjerohet:*

1. *Prioritizimi i dixhitalizimit dhe përshpejtimi i zgjerimit të mbulimit në nivel kombëtar me broadband dhe sigurimi i platformës Cloud* - iniciimi i ndërhyrjes për ato zona të vendit ku aktualisht kemi një prani të lartë të NVM-ve apo që janë më tepër të banuara (veçanërisht nga të rinjtë), pasi mbartin potenciale për të përmirësuar produktivitetin dhe efikasitetin e industrive dhe NVM-ve. Për të arritur këtë, është e nevojshme të fillojë përgatitja e hartave rajonale ku të jepet niveli i përqendrimit të NVM-ve për të mundësuar optimizimin e investimeve në infrastrukturë dhe për të rritur konkurrueshmërinë e këtyre bizneseve (*Afatshkurtër*).
2. *Saktësimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore kombëtare referuar nivelit të përdorimit dhe të aksesueshmërisë në TIK nga ana e bizneseve.* Të dhënat duhen përpunuar dhe monitoruar bazuar në indikatorë të qartë si shërbimet e përdorura nga bizneset, zonat që mbulohe, shpejtësia e mbulimit, etj.

dhe të publikohen në mënyrë që bizneset/investitorët të adoptojnë planet e tyre të investimeve. Për më tepër, *monitorimi i cilësisë së shërbimit (AKEP) për një internet broadband me shpejtësi të lartë* do t'u mundësonte shërbime cilësore si bizneseve/zyrtarëve, edhe shkollave, universiteteve, qendrave shëndetësore, institucioneve financiare, etj. (*Afatgjatë*).

3. *Të koordinohen modele (p.sh. Kosova) të bashkëpunimit qeveri-biznes-partnerë ndërkombëtarë për të financuar kostot e investimit në sektor duke qënë se për buxhetin e shtetit, pas tërmetit dhe COVID-19 mbetet sfidë. Të konsolidohet më tej mbështetja në drejtim të zhvillimeve teknologjike dhe inovacion përmes granteve apo skemave të subvencioneve (Afatgjatë).*
4. Rritja e aksesit të NVM-ve në TIK, nëpërmjet *hartimit të politikave specifike qeveritare me fokus nevojat specifike të NVM-ve.* Thjeshtëzim dhe koordinim sa më i mirë i informacionit mbi projektet evropiane (përqendrim në një portal të vetëm) me nevojat e NVM-ve lokale - që të rritet niveli i informimit, aksesueshmëria në kohë e tyre dhe cilësia e aplikimeve të biznesit në fondet e BE-së. (*Afatshkurtër*)
5. *Stimulimi i ekspozimit të popullsisë ndaj potencialeve TIK përmes bashkëpunimeve edhe me bizneset për të subvencionuar kostot e pajisjeve digjitale* si laptop, telefona smart, etj. si pajisjet e para me të cilat njerëzit qasën në internet (*Afatshkurtër*).
6. Për rritjen e aftësive në këtë sektor, nevojiten paketa trajnimesh online falas dhe certifikime respektive në aftësim dixhital, sipërmarrje, edukim financiar, të rinjtë dhe gratë, etj. Një formë stimulimi mund të jetë *edhe krijimi i një platforme online qeveritare (p.sh. Albania Digital Solidarity) ku të listohen kompanitë që ofrojnë shërbime të*

tilla online me çmime të reduktuara ose falas (si në Poloni/Itali) (Afatshkurtër).

7. *Shfrytëzimi i potencialeve që ofrojnë zonat e lira ekonomike TEDA* si një mundësi ku mund të vendosen kompani si për trajnimet ashtu edhe për zhvillimin e teknologjive që lidhen me sektorin TIK (Afatgjatë).
8. *Stimulimi i e-commerce, formalizimi ligjor i tij, si model potencial i ofrimit të shërbimeve/prodakteve* (Afatgjatë).

### c. Sektori i Turizmit

*Rekomandime të anëtarëve të KI mbi sektorin:*

1. Diversifikimi i ofertës turistike, *përmes integritimit në zinxhirë më të gjërë (globale) turistike* të shoqërohet me uljen e nivelit të informalitetit në sektor. Nga pikëpamja strategjike, duhet reduktuar varësia e të ardhurave të turizmit nga sektorët e tjerë, rritja e vlerës së shtuar të shërbimeve turistike të ofruara, krijimi i destinacioneve/paketave të diversifikuara përtej detit e diellit duke zgjeruar edhe sezonin turistik (Afatmesëm).
2. *Incentivimi i sektorit në drejtim të zgjatjes së sezonit turistik* p.sh. përmes ofrimit të subvencioneve në një masë prej 10-20 Euro për ditë/pushues për pushimet më të gjata se 3 ditë, për periudhën prill-maj dhe shtator-tetor. Kjo do të ndikonte në rritjen e fluksit turistik në periudha jo-pik, e cila mundëson angazhimin e punonjësve të këtij sektori për një sezon më të gjatë (Afatshkurtër).
3. *Cilësia e shërbimit në turizëm.* Më shumë se zgjerimi, sektori duhet të *ngrejë standardin dhe cilësinë e produktit që ofron*, duke zgjeruar paketën. Për këtë, ndoshta do të ishte efektshme një *kërkesë rregullative nga ana e*

*agjencisë shtetërore licencuese, e detyrueshme për të lejuar hyrjen në industri.* Agjencia shtetërore duhet të luajë rolin e trajnuesit, informuesit dhe koordinuesit në nivel kombëtar (Afatshkurtër).

4. Prioritet i veçantë dhe harmonizim në kohë, transparenca dhe konsultimi i *planeve lokale dhe kombëtare për investime publike në infrastrukturë në sektorin e turizmit.* Biznesi duhet të dijë çfarë do bëhet e kur do bëhet në strategjitë kombëtare të investimeve publike (ujë, kanalizime, energji, etj.). Për shembull, nëse është prioritet kombëtar si sektor, ndërtimi i hotelerisë mund të fillojë kur zona vetë ka akses në ujë e drita që të përballojë investimet e reja në kapacitete. Kjo ndihmon dhe biznesin që në avancë të krijojë planet e fizibilitetit dhe të investimit. Më specifikisht, investimet publike të synojnë a) shkurtimin e kohës së udhëtimit për në destinacionet turistike veçanërisht ato ujore, përmes projekteve madhore infrastrukturore (autostrada/aeroporte), b) ndërtimin e një sistemi cilësor shkollash hotelerie, veçanërisht për zonat bregdetare me kurrikula fleksibile që mundësojnë një shërbim cilësor në afatgjatë hotelerie për përgatitjen e të rinjve për të shërbyer në këtë industri, c) krijimin e planeve rajonale për zona turistike specifike me fokus ruajtjen e standarteve ekologjike e mjedisore (Afatmesëm).
5. *Implementimi i iniciativës “flucka e udhëtimit”, që konsiston në hapjen e kufijve midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përjashtuar detyrimin e karantinës 14 ditore,* gjë e cila do të ishte një stimul për sektorin e turizmit aktualisht (Afatshkurtër).

## SHTOJCA 1 NDËRHYRJET E QEVERISË SHQIPTARE

Shqipëria gjatë 2019 u godit nga 2 tërmete kryesore përkatësisht më 21 shtator dhe 26 nëntor 2019. Këto tërmete, veçanërisht ai i 26 nëntorit, patën një ndikim të konsiderueshëm shkatërrimtar sa i takon infrastrukturës fizike civile, publike dhe private dhe humbjeve të jetëve njerëzore (51 jetë të humbura). Pas kalimit të fazës së parë të emergjencës të orientuar në nevojat imediate humanitare, përpjekjet u fokusuan në përgatitjen e një programi të konsoliduar rindërtimi dhe të koordinuar midis Qeverisë së Shqipërisë dhe donatorëve, partnerëve për zhvillim, institucioneve financiare ndërkombëtare. Një ndër masat e para në funksion të përgatitjes së programit të rindërtimit ishte krijimi i Ministrisë së Rindërtimit në datë 13 dhjetor 2019 dhe fillimi i punës për evidentimin e dëmeve dhe impaktit ekonomik dhe social të shkaktuar në vend. Për këtë qëllim u përgatit *“Albania Post-Di-*

*aster Needs Assessment”*<sup>19</sup>, mbi bazën e një analize të detajuar që filloi më 16 dhjetor 2019 dhe përfundoi më 30 janar 2019. Analiza vlerësoi se shumica financiare e nevojshme për rimëkëmbjen nga situata e tërmetit ishte në total 1.076 milionë Euro, e ndarë kjo shumë sipas 9 sektorëve<sup>20</sup>. Raporti u prezantua më 17 shkurt 2020 në Konferencën e Donatorëve të organizuar në bashkëpunim me Komisionin Evropian, në të cilën vendet dhe institucionet/organizatat ndërkombëtare u angazhuan për një mbështetje financiare prej 1,15 miliardë Euro, nga të cilat 300 milionë grante dhe pjesa tjetër hua për mbështetjen e projekteve konkrete të rindërtimit. Dinamika e akteve për ndërtimin e kornizës ligjore dhe nënligjore të procedurave në fushën e

<sup>19</sup> PDNA- Raport i detajuar i përgatitur me bashkëpunimin e Qeverisë së Shqipërisë, BE, Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore.

<sup>20</sup> Faqet 97-101 të PDNA.

rindërtimit ka qenë mjaft e madhe<sup>21</sup>. Në mënyrë të përmbledhur masat kryesore të marra janë:

1. Përcaktimi i rregullave për funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin; ngritja e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit; rregullat e administrimit, përdorimit dhe transparencës së fondeve dhe procedurat e prokurimit.
  2. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model.
  3. Kushtet dhe procedura për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit.
  4. Shpalljen e 26 zonave të rejave të zhvillimit.
- Ndërkohë, me qëllim adresimin e menjëherëshëm të problematikave të krijuara, u morën një sërë masash dhe incentivash me karakter fiskal. Konkretisht:
- » Përfshirja në përjashtimet nga pagesa e TVSH-së e mjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për të rindërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë. Përjashtim ky i vlefshëm në rastet dhe kohëzgjatjen e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore<sup>22</sup>.
  - » Rritja e nivelit të njohjes së shpenzimeve të zbritshme nga 3% në 8% për donacionet në mjete monetare të bëra nga bizneset dhe për donacionet në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të bëra në formën e pasurive të paluajtshme. Kjo incentivë është e vlefshme për periudhën e “gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, duke mundësuar mobilizimin e mbështetjes monetare në mënyrë të men-

21 Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM nr. 5 dhe nr. 7 datë 06.01.2020, etj.

22 Akt normativ nr. 4, datë 30.11.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

jëherëshme nga sektori privat. Shpenzimet e zbritshme në masën 8% përfitohen vetëm nëse donacioni do të adresohet në llogaritë e thesarit, të vëna në dispozicion nga MFE<sup>23</sup>.

- » Dhurimi i 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë Tiranë për familjet e viktimave të tërmetit të datës 26 nëntor<sup>24</sup>.
- » Trajtimi financiar i veçantë për të mbijetuarit e familjeve me humbjet më të mëdha në njerëz nga tërmeti i datës 26 nëntor dhe pension të posaçëm qytetarëve pensionistë, që kanë humbur të afërmit nga tërmeti<sup>25</sup>.
- » Përjashtimi nga pagesa e *taksës së ndikimit në infrastrukturë* të investimeve për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore<sup>26</sup>.

Qeveria miratoi dy paketa financiare mbështetëse për individët dhe bizneset e prekura nga pandemia COVID-19 të cilat konsistojnë në shpenzime buxhetore, parashikimin e garancive shtetërore dhe shtyrje të pagimit të detyrimeve tatimore për kategori të caktuara tatimpaguesish.

23 Akt normativ nr. 5, datë 30.11.2019, “Për një shtesë në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

24 Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

25 Akt normativ nr. 7, datë 30.11.2019, “Për një shtesë në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

26 Shtuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019, në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

**Paketa financiare 1** u lançua më 19 mars 2020 dhe parashikonte masa të përqendruara kryesisht tek individët dhe bizneset e vogla të prekura nga bllokimi i aktiviteteve për shkak të masave në kuadër të pandemisë. Paketa parashikonte masa mbështetëse prej 23 miliardë lekësh (1,4 përqind e PBB-së) përmes një kombinimi të rialokimeve të shpenzimeve, rritjeve të shpenzimeve dhe garancisë shtetërore për të mbështetur bizneset e prekura<sup>27</sup>. Elementet kryesore të paketës:

- » 6,5 miliardë lekë për mbështetjen e bizneseve të vogla/të vetëpunësuarve që janë të detyruar të mbyllin aktivitetet për shkak të pandemisë COVID-19 duke paguar pagat minimale (deri në dy në rastin e bizneseve familjare me familjarë të papaguar), duke dyfishuar pagesën e papunësisë dhe të ndihmës sociale;
- » 2 miliardë lekë të shpenzimeve në fushën e mbrojtjes të alokuara në ndihmë humanitare për më të prekurit;
- » Fondi i garancisë sovraane prej 11 miliardë lekësh (0,6 përqind e PBB-së) për kompanitë që të përdorin kreditë/overdraftet në sistemin bankar për të paguar pagat për punonjësit e tyre deri në 3 muaj me një normë interesi në 2,85 përqind dhe për një maturim deri në 2 vjet.

**Paketa financiare 2** u lançua më 13 prill 2020 dhe përmbante masa për mbështetjen e kategorive të bizneseve që nuk ishin subjekt i mbështetjes së menjëherëshme të ofruar nga paketa fiskale 1. Karakteristikat kryesore të kësaj pakete:

- » Fondi 7 miliardë lekë për një ndihmë financiare prej 40.000 lekësh për punonjësit e bizneseve të vogla të prekura nga pandemia që

27 Të dhëna të analizuara dhe të raportuara nga FMN.

nuk janë përfshirë në paketën e parë, punonjësit e bizneseve të mëdha të pushuar për shkak të pandemisë dhe për punonjësit në sektorin e turizmit;

- » Masat e shtyrjes së taksave që lejojnë të gjitha kompanitë (përveç bankave, telekomunikacionit, ndërmarrjeve publike dhe kompanive në zinxhirin e furnizimit të mallrave thelbësorë) të shtyjnë pagesën e tatimit mbi fitimin pas shtatorit. Turizmi, përpunimi aktiv dhe *call centers* - si dhe bizneset e vogla me qarkullim deri në 14 milionë ALL - nuk do të paguajnë këstet e parapagimit të tatimit mbi fitimit për vitin 2020;
  - » Garanci shtetërore prej 15 miliardë lekësh (0,9 përqind e PBB-së) për të siguruar kredi për kapital qarkullues dhe investime për të gjithë sektorët. Ky është një instrument që ndan rrezikun me bankat, qeveria mbulon 60% të principalit të çdo kredie dhe parashikon kushte shlyerjeje deri në 5 vjet. Parashikohet gjithashtu, periudhë pa shlyerje të principalit (*grace period*) prej 6 muajsh.
- Përveç sa më sipër, u morën masa të tjera të rëndësishme si:

- » Që prej muajit prill, ministrat e kabinetit dhe ligjvënësit marrin gjysmën e pagave të tyre për tre muajt e ardhshëm me kursimet që shkojnë në fondin e mbështetjes sociale Anti-Covid 19. Vendime të tilla janë miratuar nga institucione të tjera si Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, AMF, etj.;
- » Pezullimi i katër kontratave për PPP dhe procedurat e prokurimit publik;
- » Banka e Shqipërisë dhe Kryeministria urdhëruan bankat e nivelit të dytë të shtyjnë për një periudhë 3 mujore pagimin e normave të interesit të pagesës për këste nga sektori privat;

» Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:

- (1) pezulloi shpërndarjen e dividendit nga bankat deri në fund të qershorit 2020 për: (a) fitimin e akumuluar të bartur nga periudhat e mëparshme; (b) fitimet e realizuara në vitin 2019 dhe (c) fitimin që do të realizohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2020;
- (2) duke filluar nga 10 prill 2020, hoqi komisionet për transferime në monedhën vendase, si dhe tarifën për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë. Kjo masë kërkon përdorimin e shërbimeve *e-banking* dhe synon të zvogëlojë numrin e njerëzve që kërkojnë shërbime në ambientet e bankës.

Informacioni periodik dhe/ose i konsoliduar mbi masat fiskale, makro-financiare ose institucionale janë publikuar në dritaren e dedikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Investimeve, <https://www.investment.com.al/sq/covid-19/>.

Shqipëria është ende nën gjendjen e fatkeqësisë natyrore deri më 23 qershor 2020, gjë që i mundëson qeverisë të përdorë kompetencat e zgjeruara.

Tërmeti më 26 nëntor 2019 dhe shpërthimi global i pandemisë COVID-19 kanë shkaktuar humbje dhe ndërprerje të konsiderueshme në ekonominë e Shqipërisë. Për të adresuar nevojën urgjente të bilancit të pagesave të Shqipërisë, FMN-ja aprovoi ndihmë financiare 190,5 milionë dollarë (174 milionë Euro) në kuadër të Instrumentit të Financimit të Shpejtë.

## SHTOJCA 2

### MASAT DHE PAKETAT FINANCIARE MBËSHTETËSE NË KUADËR TË COVID-19, BALLKANI PERËNDIMOR DHE KROACIA

**S** **HËNIM:** Kjo përmbledhje përmban dhe strukturon informacion të përgjithshëm të marrë nga publikimet e FMN, BERZH; OECD, KPMG & Deloitte dhe burime të tjera të respektueshme si

edhe në referim të kuadrit ligjor të vendeve përkatëse. Informacioni i përfshirë në këtë përmbledhje nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t'ju duhet ju apo institucioneve përkatëse.

## FISKALE

| Shteti    | Masat   |
|-----------|---|
| Shqipëria | <p>Qeveria ka miratuar dy paketa mbështetëse për njerëzit dhe bizneset e prekura nga pandemia COVID-19 me një shumë prej 45 miliardë lekësh (2,8 përqind e PBB-së) që konsistojnë në shpenzime buxhetore, garanci sovraane dhe shtyrje të pagimit të detyrimeve tatimore për kategori të caktuara tatimpaguesish.</p> <p>Paketa 1: masa mbështetëse prej 23 miliardë lekë (1,4% e PBB) përmes një kombinimi të rialokimeve të shpenzimeve, rritjeve të shpenzimeve dhe garancive sovraane për të mbështetur bizneset e prekura. (1) fonde shtesë për sektorin e shëndetësisë në një shumë prej 3,5 miliardë lekë; (2) 6,5 miliardë lekë për mbështetjen e bizneseve të vogla/të vetëpunësuar që u detyruan të mbyllnin aktivitetet për shkak të pandemisë COVID-19, që konsiston në pagimin e pagave minimale (deri në dy për rastin e bizneseve familjare me familjarë të paguar); dyfishimi i pagesës së papunësisë dhe ndihmës sociale; (3) 2 miliardë lekë të shpenzimeve të mbrojtjes u rialokuan në ndihmë humanitare për më të prekurit; (4) 11 miliardë lekë (0,6% e PBB-së) fond për garanci sovraane për kompanitë që të përdorin 'overdraftin' e tyre në sistemin bankar për të paguar pagat për punonjësit e tyre deri në 3 muaj me një normë interesi në 2.85 përqind për një maturim deri në 2 vjet; (5) Që prej muajit prill, ministrat e kabinetit dhe ligjvënësit do të marrin gjysmën e pagave të tyre për tre muajt e ardhshëm, këto kursime shkojnë në fondin e mbështetjes sociale Anti-Covid 19.</p> <p>Paketa 2: (1) Fondi prej 7 miliardë lekë (0,4% e PBB-së) për një ndihmë financiare prej 40.000 lekë për punonjësit e bizneseve të vogla të prekura nga pandemia që nuk përfshihen në paketën e parë, punonjësit e bizneseve të mëdha që u shpëputën nga puna për shkak të pandeminë, dhe punonjësit në sektorin e turizmit; (2) masat e shtyrjes së taksave që lejojnë të gjitha kompanitë (përveç bankave, telekomunikacionit, ndërmarrjeve publike dhe kompanive në zinxhirin e furnizimit të mallrave thelbësorë) të shtyjnë pagesën e tatimit mbi fitimin pas shtatorit. Turizmi, përpunimi aktiv dhe call-centers - si dhe bizneset e vogla me qarkullim deri në 14 milionë ALL - nuk do të paguajnë këstet e parapagimit të tatimit mbi fitimin për vitin 2020; (3) një garanci shtetërore prej 15 miliardë lekësh (0,9 përqind e PBB-së) për të siguruar kredi për kapital qarkullues dhe investime për të gjithë sektorët. Ky është një instrument që ndan rrezikun me bankat, qeveria mbulon 60% të principalit të çdo kredie dhe parashikon kushte shlyerjeje deri në 5 vjet. Parashikohet gjithashtu, periudhë pa shlyerje të principalit (<i>grace period</i>) prej 6 muajsh.</p> |
| Kosova    | <p>Masat tatimore të fokusuar në: (1) alokimin prej 6 milionë € për ministrinë e shëndetësisë; (2) shtyrjet e pagimit të detyrimeve për të ardhurat e korporatave, tatimin mbi të ardhurat personale, dhe TVSH-në; (3) parapagimin e pagesave për skemat e ndihmës sociale me një shumë shtesë për një muaj (nga një muaj në dy muaj) për të mbështetur familjet në nevojë; (4) heqja e TVSH-së në importet e grurit dhe miellit; (5) shtyrja e pagesave të faturave të shërbimeve publike deri në fund të prillit. Në vijim, paketa fiskale me një vlerë prej 170 milionë euro (2,5% e PBB-së) u miratua nga qeveria.</p> <p>(1) Mbulimi i pagave mujore me një shumë prej 170 euro për punonjës për periudhën prill-maj 2020. Shuma totale e kësaj mase është 41 milionë euro. Përveç pagave të mbuluara, qeveria do të paguajë edhe kontributet të lidhura me pensionet për periudhën prill-maj 2020, në shumën totale prej 8 milionë euro; (2) Subvencionim për qeratë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në masën 50% të qerave mujore, për periudhën prill-maj 2020, në shumën totale prej 12 milionë euro.</p>   |

Maqedonia  
e Veriut

Paketa 1- (0,2% e PBB-së) për të ndihmuar në adresimin e problemeve të likuiditetit të sipërmarrjeve dhe mbrojtjen e vendeve të punës, të destinuara për sektorët e prekur si transporti, hotelitë dhe restorantet për tre muaj duke filluar nga prilli. Masat përfshijnë (1) subvencionim për kontributet e sigurimeve shoqërore për firmat që kanë mbajtur të punësuarit gjatë pandemisë; (2) shtyrja e pagesave të taksave të të ardhurave të korporatave duke pezulluar detyrimet për parapagim bazuar në të ardhurat e vitit të kaluar, dhe (3) ndihmë e drejtpërdrejtë financiare për firmat nga Banka e Zhvillimit, duke ofruar kredi me normë interesi 0.

Paketa 2- (rreth 1% e PBB-së). (1) Një subvencion për pagat e barabartë me pagën minimale për kompanitë e prekura për t'i ndihmuar ato që të mbajnë punonjësit në punë. (2) Familjet e riskuara që ishin pjesë e ekonomisë informale dhe humbën të ardhurat e tyre do të marrin ndihmë financiare. (3) Financime shtesë do të vihen në dispozicion nga Banka e Zhvillimit për bankat tregtare me kushte të favorshme. (4) Qeveria ka zbatuar gjithashtu kontrolle çmimesh për produktet kryesore ushqimore, medikamentet dhe produktet e dezinfektimit, dhe ka hequr detyrimin e importit për materialet mjekësore.

Paketa 3-

(1) Si pjesë e paketës së tretë të masave, Qeveria po planifikon të shpërndajë kupona pagesash të kredituara me 3.000 denarë dhe 6.000 denarë kuponë për të stimuluar turizmin vendas nga familjet më të varfra. Masa do të prekë rreth 100.000 qytetarë nga familjet më të varfëra, d.m.th. të cilët fitojnë më pak se 15.000 denarë në muaj (paga minimale është 14.500 denarë në muaj). Kuponat do të përdoren në hotelet-shtëpi dhe ambiente të tjera akomodimi, për të inkurajuar blerjen e produkteve dhe shërbimeve të turizmit vendas. (2) Paketa e tretë e masave që mbështesin bujqësinë do të mobilizojnë deri në 76,1 milionë EUR. Ajo përfshin mbështetje për ndërmarrjet mikro dhe NVM; mbështetje të drejtpërdrejt për fermerët që kultivojnë kulturat për *Green Oil*. Masa do të përfshijë 50.000 fermerë dhe është me vlerë 4,6 milionë EUR; Mbështetja për përpunuesit e rrushit dhe verërat me 3,5 milionë EUR për tre vjet për të stimuluar prodhimin e alkoolit që do të përdoret nga kompanitë kimike vendase për të prodhuar dezinfektues; Qiraja afatgjatë e kullotave për të mbështetur blegtorët dhe një Program për financimin e ndërmarrjeve mikro-bujqësore në vlerë prej 3 milionë EUR për pajisjet e përpunimit dhe marketingun.

## Serbia

Masat fiskale (6,5 përqind e PBB-së) u përqëndruan në: (1) rritje të pagave me 10% për sektorin e shëndetësisë publike (13 miliardë RSD) dhe rritjen e shpenzimeve për shëndetësinë (rreth 26 miliardë RSD); (2) pagesa për të gjithë pensionistët (7 miliardë RSD); (3) një transfertë, prej 100 euro për secilin qytetar mbi 18 vjeç (rreth 65 miliardë RSD); (4) shtyrja tre-mujore e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për të gjitha kompanitë private, për t'u paguar me 24 këste duke filluar nga viti 2021 (100 miliardë RSD); (5) shtyrja e pagimit të kësteve për parapagimin e taksave të të ardhurave të korporatës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 (21 miliardë RSD); (6) subvencione për pagat, përfshirë pagimin e pagave minimale për të gjithë punonjësit e NVM-ve dhe sipërmarrësit për tre muaj (93 miliardë RSD) dhe pagesa e 50% të pagës minimale neto për tre muaj për punonjësit në ndërmarrje të mëdha të sektorit privat dhe për të papunësuarit (4 miliardë RSD). (7) moratorium 3-mujor për interesat e borxhit tatimor në bazë të marrëveshjeve të ristrukturimit dhe reduktimit me 10 pikë përqindje të normës së interesit të borxhit tatimor. (8) Një garanci nga shteti është aprovuar për kreditë bankare për NVM-të (240 miliardë RSD), si dhe për kreditë e reja për NVM-të nga Fondi i Zhvillimit (24 miliardë RSD).

|                                 |   |
|---------------------------------|---|
| <b>Bosnja &amp; Hercegovina</b> | (1) Masat e marra nga Federata e Bosnja dhe Hercegovinës (FBiH) përfshijnë subvencionimin e kontributeve dhe taksave, pagimin e pagave minimale të të gjithë kompanive të prekura nga pandemia Covid-19; (2) Rep. Serbska vendosi të mbulojë PIT dhe SSC për rreth 40.000 punëtorë në sektorët që janë mbyllur me vendim të qeverisë nga marsi deri në maj (50 milionë KM, 0,15% e PBB-së). Gjithashtu, njoftoi se qeveria do të paguajë pagat minimale për të gjithë punonjësit në këta sektorë në prill (53 milionë KM, 0,16% e PBB-së) dhe po planifikon rritjen e transferimeve në fondet e papunësisë (25 milionë KM, 0,08% e PBB-së).   |
| <b>Mali i Zi</b>                | Paketa 1: (1) heqja e akcizës për alkoolin mjekësor të shitur në farmaci; (2) shtyrje e pagesave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore; (3) krijimi i një linje kredie të Fondit të ri të Zhvillimit të Investimeve (IRF) prej 120 milionë euro për të përmirësuar likuiditetin e sipërmarrësve; (4) shtyrja e pagesave të qirasë për pronat e paluajtshme shtetërore; (5) paradhënie për kontraktuesit për projektet kapitale; (6) ndihmë financiare për pensionistët me të ardhura të ulëta dhe përfituesit e mirëqenies sociale në shumën prej 50 euro secila kategori (1 milionë euro është ndarë); (7) një rritje në pagat e muajit mars të punonjësve të sektorit shëndetësor deri në 15 përqind (janë ndarë 0,5 milionë euro).<br>Paketa 2: në shumën prej 75 milionë euro (me një ndikim neto prej 40 milionë euro) përfshin: (1) subvencione në prill dhe maj me 70% të pagës minimale për punonjësit në sektorë që janë mbyllur për shkak të pandemisë, punonjësit që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të kujdesit të fëmijëve për fëmijët e moshës nën 11 vjeç, ose njerëzit që duhet të jenë të izoluar dhe të karantinuar; (2) një subvencion prej 50% të pagës minimale për të punësuarit në sektorët me risk për shkak të bllokimit nga pandemia; (3) një subvencion prej 70% të pagës minimale bruto të sapopunësuarve në NVM për gjashtë muaj nëse këta punëtorë janë regjistruar si të papunë; (4) organet shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore do të vendosin një moratorium gjashtëmuajor në zbatimin e kërkesave për kompanitë që nuk funksionojnë për shkak të pandemisë; (5) firmat e energjisë elektrike do të përjashtojnë pagesën fikse nga faturat e energjisë për bizneset që nuk kanë aktivitet për shkak të pandemisë (6) ndërmarrja shtetërore do të dyfishojë subvencionet e energjisë elektrike për familjet në nevojë; (7) ndihmë për sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, duke përfshirë ndihmën financiare për peshkatarët dhe pagesa për kontributet e punëtorëve të siguruar bujqësorë; dhe (8) ndihmë prej 50 euro për të gjithë personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit të Malit të Zi dhe që nuk kanë marrë asnjë kompensim tjetër. |
| <b>Kroacia</b>                  | Masat fiskale: (1) shtyrja e detyrimeve publike, pa interes për tre muaj, e cila mund të zgjatet edhe për tre muaj të tjerë nëse është e nevojshme; (2) pezullimi i përkohshëm i pagesave të tarifave parafiskale; hua pa interes për qeveritë lokale, Institutin Kroat të Sigurimeve Shëndetësore dhe Institutin Kroat të Sigurimeve për Pensionet për të mbuluar pagesat e shtyra; (3) subvencionimi i pagave minimale për tre muaj për të ruajtur vendet e punës, të cilat mund të zgjaten edhe për tre muaj të tjerë; (4) rimbursimi i parakohshëm i tatimeve për individët; (5) një rritje e subvencionimit të pagës minimale neto; (6) reduktimin ose fshirjen e detyrimeve tatimore për ndërmarrjet në varësi të xhiros dhe humbjeve të tyre; (7) Pagesat e TVSH-së nuk do të kryhen derisa të merren pagesat nga klientët dhe afati për raportimet financiare të vitit 2019 do të zgjatet deri më 30 qershor.   |

## SEKTORIALE

| Shteti                          | Masat   |
|---------------------------------|---|
| <b>Shqipëria</b>                |   |
| <b>Kosova</b>                   | (1) Mbështetja për likuiditetin financiar do të shtrihet në ndërmarrjet e vogla dhe të vetëpunësuarit në shumën prej 10 mijë euro për një periudhë maksimale prej 24 muajsh, në një total prej 15 milionë euro. (2) Mbulimi i pagave mujore prej 130 euro do të jepet për dy muajt e parë për çdo punonjës të ri të punësuar gjatë situatës COVID-19 me një kontratë me afat të përcaktuar të paktën një vit. Mbulimi i përgjithshëm arrin në 6 milionë euro. (3) Ndihma financiare për eksportuesit pas përfundimit të situatës së COVID-19 do të jetë në shumën totale prej 10 milionë euro. (4) Mbështetje për grante dhe institucione qeveritare - Një shumë totale prej 20 milionë euro është miratuar për të rritur buxhetin për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe bashkitë e prekura nga situata pandemike.  |
| <b>Maqedonia e Veriut</b>       | (1) Shtyrje të afateve për pagimin e kësteve;<br>(2) Një total prej 5,5 milionë euro do të jepet si hua pa interes për kompanitë që kryejnë aktivitete biznesi në sektorët më të prekur nga COVID-19.   |
| <b>Serbia</b>                   |   |
| <b>Bosnja &amp; Hercegovina</b> | Mbështetje për ekonominë përmes: (1) ngritjes së një fondi të veçantë për të stabilizuar ekonominë (500 milionë KM, 1,5% e PBB-së); dhe (2) krijimi i një fondi garancie në Bankën e Zhvillimit (deri në 500 milionë KM, 1,5% e PBB-së) i cili do të shërbejë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e likuiditetit të kompanive. Gjithashtu, zhvillimin e një skeme mbështetëse për garantimin e kredisë.   |
| <b>Mali i Zi</b>                |   |
| <b>Kroacia</b>                  | (1) Përfituesit e investimeve dhe disa fondeve strukturorë të BE-së do të jenë në gjendje të marrin parapagime. Një pjesë e fondeve të BE-së është shpërndarë në mikro kredi, duke prezantuar një linjë të re krediti, e shoqëruar me masa për të lehtësuar disbursimet e shpejta të kredive me norma më të ulëta të interesit, dhe garanci më të mëdha nga riskut të pjesshëm.<br>(2) Qeveria ka ndihmuar në blerjen e stoqeve të pashitura të mallrave të gatshëm në bujqësi, industrinë e përpunimit ushqimor, pajisjeve mjekësore dhe mallrave strategjikë.<br>(3) Financim për pezullimin e përkohshëm të sektorit të peshkimit me miratimin paraprak të Komisionit Evropian.<br>(4) Ndihma për sektorin e bujqësisë për shkak të kufizimeve të lëvizjeve dhe rritjes së kostove të manipulimit.<br>(5) Rritje e fondeve për ndihmë minimale për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.<br>(6) Krijimi i një linje kredie për kapitalin qarkullues për sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe përpunimit të drurit.<br>(7) Ndihma shtetërore: Komisioni i BE miraton skemën e granteve të drejtpërdrejta kroate prej 4 milionë € për të mbështetur sektorin e peshkimit dhe akuakulturës për shkak të pandemisë. |



## MONETARE

| Shteti                    | Masat   |
|---------------------------|---|
| <b>Shqipëria</b>          | <p>A. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:</p> <p>(1) pezullimin e shpërndarjes së dividendit nga bankat deri në fund të muajit qershor 2020 për: (a) fitimin e akumuluar të mbartur nga periudhat e mëparshme; (b) fitimet e realizuara në vitin 2019 dhe (c) fitimi që do të realizohet gjatë gjysmës së parë të vitit 2020;</p> <p>(2) duke filluar nga 10 prilli 2020, heqja e komisioneve për transferime në monedhën vendase, si dhe për tarifën për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH të operuara nga Banka e Shqipërisë. Kjo masë kërkon përdorimin e shërbimeve <i>e-banking</i> dhe synon të reduktojë numrin e njerëzve që kërkojnë shërbime në ambientet e bankës.</p> <p>B. Banka e Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë vendosën që bankat e nivelit të dytë të shtyjnë për një periudhë 3 mujore pagimin e kësteve të kredisë nga sektori privat në fazën e parë dhe 3 muaj në fazën e dytë, pra gjithsej deri më 31.08.2020.</p>               |
| <b>Kosova</b>             | <p>(1) Një shumë totale prej 20 milionë euro do jepet në formë kredie pa interes të ripagueshme deri më 31 dhjetor 2020, për ndërmarrjet shtetërore të cilat përballesh me vështirësi financiare, personat juridikë/ndërmarrje të autorizuara për të ofruar shërbime thelbësore; (2) Banka Qendrore e Kosovës, së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës vendosën të pezullojnë pagesën e kësteve të kredisë për bizneset dhe individët duke filluar nga 16 marsi deri më 30 prill. Ky pezullim mund të zgjatet në varësi të situatës. BQK-ja do të zbatojë kontrollin rregullator mbi provizionet e kredisë dhe kërkesat e kapitalit për kreditë e riprogramuara.</p>   |
| <b>Maqedonia e Veriut</b> | <p>Masat nga Banka Kombëtare:</p> <p>(1) Reduktimi i nivelit të normës së politikës me 25 pikë bazë, në 1,75.</p> <p>(2) Tarifën për tërheqjen dhe kthimin e parave në kasafortën qendrore të Bankës Kombëtare janë hequr për të minimizuar çdo risk të transmetimit të infeksionit të virusit me anë të monedhave dhe faturave.</p> <p>(3) Rishikimi i rregullores së riskut të kredisë, për të inkurajuar bankat që të ristrukturojnë përkohësisht huatë duke lehtësuar standardet e klasifikimit të kredive të këqija (NPL). Gjithashtu ka ulur bazën për kërkesat e rezervës me sasinë e kredive të reja për firmat në sektorët e prekur, dhe ka zgjeruar afatin që bankat të paraqesin Raportin e parë të Vlerësimit të Likuiditetit të Brendshëm në mënyrë që të lejojë përqendrimin në sigurimin e kredisë duke ruajtur cilësinë e portofolit të kredisë.</p>  |
| <b>Serbia</b>             | <p>Masat nga Banka Kombëtare:</p> <p>(1) ulja e normës bazë të politikës nga 2,25% në 1,75% dhe më vonë në 1,50% dhe ngushtimi i intervalit të normës së interesit nga <math>\pm 1,25</math> pikë përqindje në <math>\pm 1</math> pikë përqindje në krahasim me normën kryesore të politikës.</p> <p>(2) sigurimi i likuiditetit për bankat (si në dinarë ashtu edhe në euro) përmes ankandëve shtesë të këmbimit EUR/RSD dhe ankandëve për blerjen e të letrave me vlerë (REPO) të qeverisë;</p> <p>(3) ulja e normave të interesit në këmbimin valutor;</p> <p>- Moratorium për qiradhënie dhe kredi, përfituesit kanë të drejtë të vonojnë pagesat e detyrimeve që kanë ardhur brenda 3 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e vendimit.</p> <p>- Ofruesit e qirasë nuk mund të faturojnë interes për borxhet e prapambetura dhe nuk mund të fillojnë procedurën e arkëtimit kundër qiramarrësit, ose të ndërmarrin ndonjë veprim tjetër ligjor për të mbledhur arkëtimet nga qiramarrësi.</p> |

|                                 |  |
|---------------------------------|--|
| <b>Bosnje &amp; Hercegovina</b> | <p>(1) Agjencitë bankare kanë njoftuar një moratorium 6 mujor për shlyerjen e kredisë, për të rregulluar ristrukturimin e kredisë për individë dhe persona juridikë, për të cilët është konstatuar se gjenden në rrethana të vështira për shkak të COVID-19. (2) Agjencitë bankare kanë udhëzuar bankat të gjurmojnë klientët dhe portofolet e prekura nga COVID-19. Bankat gjithashtu udhëzohen të marrin në konsideratë lehtësimin konsumator, përfshirë rishikimin e tarifave aktuale për shërbimet dhe shmangien e tarifimit për të përballuar ekspozimin ndaj ndryshimeve; (3) Të gjitha bankave u është dhënë urdhër për të mos paguar dividendë ose shpërblime.</p>   |
| <b>Mali i Zi</b>                | <p>Masat e Bankës Qendrore:</p> <p>(1) moratorium për shlyerjen e kredisë për një periudhë deri në 90 ditë. Përfshirë pezullimin e përkohshëm të të gjitha pagesave të detyrimeve të bazuara në kredi (principali, kamata, interesi i paracaktuar, tarifën, etj.).</p> <p>(2) Gjithashtu, bankat mund të ristrukturojnë kreditë dhe t'i riklasifikojnë ato si kredi të reja, duke përfshirë duke zgatur periudhën e ripagimit deri në dy vjet, nëse pozicioni financiar i huamarrësit është ndikuar nga pandemia dhe ristrukturimi do të përmirësonte kapacitetin e kredisë së huamarrësit. Këto masa vlejnjë gjithashtu edhe për institucionet e <i>leasing</i> dhe të mikrofinancës.</p> <p>(3) Banka qendrore ka njoftuar masa për të ndaluar përkohësisht bankat të paguajnë dividendë ndaj aksionerëve, përveç në formën e kapitalit neto, dhe të lejojnë bankat të rrisin ekspozimet ndaj një personi ose palëve të lidhura përtej kufijve të parashikuar të ekspozimit (25% të fondeve të vetë bankës), me miratimin paraprak të bankës qendrore.</p> <p>(4) Po konsiderohen masa shtesë, përfshirë shtrirjen e moratoriumit tek huamarrësit më të rrezikuar, sigurimin e hyrjes në linjat e kreditit për sistemin financiar përmes BERZH-it dhe Korporatës Ndërkombëtare të Financave (IFC), dhe uljen e çmimit të tërheqjes së rezervave të kërkuara për likuiditetin bankar.</p> |
| <b>Kroacia</b>                  | <p>Banka Kombëtare siguroi likuiditet përmes:</p> <p>(1) marrëveshtjet Repo, i përdorur për herë të parë që nga dhjetori i vitit 2018 (likuiditeti 5-vjeçar prej 3,8 miliardë HRK me një normë fikse të interesit prej 0,25 përqind);</p> <p>(2) Repo të rregullta javore të përdorura nga bankat për herë të parë që nga dhjetori 2017. Kjo normë e repos është reduktuar nga 0,30% në 0,05% ; dhe</p> <p>(3) një ulje e normës së kërkesës së rezervës (nga 12% në 9%)</p> <p>- Vendosja e një moratoriumi 3 mujor mbi obligacionet bankare. Bankat nuk mund të zbatojnë masat e mbledhjes gjatë kësaj periudhe.</p> <p>- Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR) ka lëshuar një moratorium për shërbimin e borxhit për tre muaj, sigurimin e kredisë për likuiditet, garanci për eksport dhe detyrime të ristrukturimit. Në prill, Komisioni Evropian miratoi programet e subvencionuara të kredisë deri në 1,8 miliardë € .</p>   |

## TË TJERA

| Shteti               | Masat   |
|----------------------|---|
| Shqipëria            | (1) Duke filluar nga prilli, ministrat e kabinetit dhe ligjvënësit do të marrin gjysmën e pagave të tyre për tre muajt e ardhshëm, këto kursime shkojnë në fondin e mbështetjes sociale Anti-Covid 19. Vendime të tilla janë miratuar edhe nga institucione të tjera si Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, AMF etj.;<br>(2) Pezullimi i katër kontratave të PPP-së dhe procedurave të prokurimit publik;<br>(3) Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përgjysmoi pagat e bordit mbikëqyrës të tij dhe menaxhimit të nivelit të lartë në Bankën e Shqipërisë për kohëzgjatjen e pandemisë. |
| Kosova               |   |
| Maqedonia e Veriut   | (1) Masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve:<br>- Autoritetet tatimore njoftuan se nuk do të bëjnë asnjë mbledhje të detyruar në lidhje me të gjitha taksat dhe tarifatat e tjera publike (gjjobat, tarifatat gjyqësore) ndaj tatimpaguesve që nuk kanë paguar detyrimet e tyre.<br>- Pezullimi për ligjin e përmbarimit deri në fund të qershorit, duke detyruar agjentët e përmbarimit të ndalojnë ndërmarrjen e çdo veprimi përmbarimi.   |
| Serbia               |   |
| Bosnja & Hercegovina |   |
| Mali i Zi            | (1) Shtyrja e pagesave të qirasë për pasuritë e paluajtshme për një periudhë 90 ditore.<br>(2) Pagesa paraprake për ofruesit e shërbimeve dhe kontraktuesit për projektet kapitale duke filluar me sigurimin e një garancie bankare në vlerën e paradhënies për të siguruar likuiditetin dhe për të ruajtur vazhdimësinë e punës, kur kjo nuk rrezikon shëndetin e qytetarëve.  |
| Kroacia              |   |

## SHTOJCA 3

PYETËSOR I SKI DREJTUAR ANTARËVE  
DHE PARTNERËVE TË KI

*Të nderuar Anëtarë dhe Bashkëpunëtorë të Këshillit të Investimeve,*

Në vijim të takimit të jashtëzakonshëm të KI (14 prill 2020), në lidhje me masat afatshkurtra në përgjigje të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë së COVID-19, Sekretariati i KI në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka filluar një raund të ri konsultimesh me anëtarët dhe bashkëpunëtorët e KI me *fokus rimëkëmbjen e vendit.*

Qëllimi i këtyre konsultimeve është mbledhja e propozimeve mbi opsionet e mundshme të ndërhyrjeve për rimëkëmbjen ekonomike, të cilat adresojnë jo vetëm mbijetesën e bizneseve dhe vendeve të punës, por ofrojnë edhe pikëpamje mbi prioritetimin e reformave në afatmesem dhe afatgjatë, të duhura për ekonominë shqiptare.

Një nga mësimet e nxjerra nga rënia ekonomike gjatë krizës financiare të vitit 2008 dhe paketat stimuluese pas saj, është se *transparenca dhe qëndrueshmëria e investimeve publike drejt sektorëve*

*me potenciale të larta janë masat e duhura për të siguruar prosperitet afatgjatë.* Ndërsa, duhet të rindërtojmë ekonominë e vendit tonë, ne mund të kemi një mundësi reale për të reflektuar mbi një rimëkëmbje gjithëpërfshirëse e cila të mund të funksionojë më mirë për të gjithë.

Rezultati i këtyre konsultimeve, pritet të jetë një listë sugjerimesh mbi *prioritetimin e ndërhyrjeve në kuadrin e politikave më afatgjata për rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare.* Këto do t'i prezantohen më pas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në takimin e ardhshëm të KI (qershor 2020).

Për të lehtësuar mbledhjen e mendimeve dhe arsyetimit tuaj të vlefshëm kemi përgatitur disa pyetje si më poshtë:

(a) *Përfaqësja horizontale:*

1. Cilat mund të jenë aksionet konkrete (afatmesme dhe afatgjata) ose reformat prioritare në nivel politikash mbi bazën e të cilave ekonomia në tërësi mund të lulëzojë

në planin afatmesëm/afatgjatë? Nëse është e mundur, ju lutemi theksoni ndryshimet në nivel institucional, ligjor dhe rregullator ose nisma të reja (*përfshirë zëvendësimin e importit, opsionet mbi politikat eksportuese, prodhimi shqiptar "Made in Albania", etj.*) që mund të jenë të nevojshme për të mbështetur reformat.

(b) *Përfaqësja sektoriale:*

2. Nëse është e mundur, lutem për zgjidhni sipas rëndësisë veprimtaritë e mëposhtme (nga më e rëndësishmja tek më pak e rëndësishmja) dhe priorizimi cilat mund të jenë masat dhe ndërhyrjet konkrete:
  - a. Agrobiznesi
  - b. Ndërtimi
  - c. Industria
  - d. Turizmi
  - e. Tregtia (e-commerce)
  - f. Shërbimet
  - g. Transporti
  - h. Të tjera si p.sh. eco, bio, etj.
3. Si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19, shumë kompani po rishikojnë zinxhirin e tyre të furnizimit sidomos nga tregjet aziatike. Sipas, këndvështrimit tuaj, cila është mundësia reale e zgjerimit të zinxhirit të operacioneve në Shqipëri për të përmbushur kërkesat në:

- (a) Industrinë përpunuese
- (b) Agro-përpunim
- (c) Turizëm
- (d) Shëndetësi
- (e) Shërbime
- (f) Tjetër

Cfarë mbështetje do të ishte e nevojshme që ky transformim të ndodhë?

4. Ju lutemi rendisni 3 masa konkrete që duhen ndërmarrë me qëllim tërheqjen e bizneseve të reja ose mbështetjen e përpjekjeve në vend për secilin nga sektorët e mësipërm.
5. *Mësimet pas pandemisë së COVID-19* – Çfarë do të ndryshoni në *modelin tuaj të bërit biznes* në:
  - a) afat-shkurtër b) afat-mesëm c) afat-gjatë

(c) *Punësimi*

6. Çfarë ndërhyrjesh (p.sh. *teleworking*, etj.) janë të nevojshme për t'u rikthyer në nivelet e punësimit të para krizës së COVID-19? Po për krijimin e vendeve të reja të punës?

Ju lutemi rendisni 3 masa konkrete sipas gjykimit tuaj.

(d) *Tjetër*

7. Ju lutemi të përfshini këtu ndonjë rekomandim tjetër që jo domosdoshmërisht korrespondon me çështjet e mësipërme, por që sipas jush do të mbështesin politikat dhe reformat e mëtejshme.

## BIBLIOGRAFIA

1. *Regular Economic Report, Spring 2020, World Bank*
2. *European Economies Forecast, Spring 2020, European Commission*
3. *Albanian Post Disaster Needs Assessment, February 2020*
4. *EBRD Regional Economic Prospects, May 2020*
5. *World Bank Group Briefing Note: Navigating the Albanian Economy through the COVID-19 Crisis*
6. *Harnessing the Power of Connectivity, Global Connectivity Index*
7. *Plani Kombëtar për zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025*
8. *Exploring the Relationship Between Broadband and Economic Growth*
9. *European Union Report Albania 2019*
10. <https://content.govdelivery.com/accounts/USIMF/bulletins/28alba5>
11. <https://www.euronews.com/2020/05/06/the-eu-s-covid-19-budget-and-recovery-plans-must-ensure-a-safe-and-healthy-future-view>
12. <https://www.oecd.org/cfe/lead/COVID-19-Italian-regions-SME-policy-responses.pdf>
13. [http://www.oecd.org/naec/projects/resilience/NAEC\\_Resilience\\_and\\_Covid19.pdf](http://www.oecd.org/naec/projects/resilience/NAEC_Resilience_and_Covid19.pdf)
14. [https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=119\\_119680-di6h3ggi4x&title=Covid-19\\_SME\\_Policy\\_Responses](https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=119_119680-di6h3ggi4x&title=Covid-19_SME_Policy_Responses)
15. <https://www.oecd.org/general/searchresults/?q=SME%20response%20to%20COVID&cx=012432601748511391518:xze-adub0b0a&cof=FORID:11&ie=UTF-8>
16. <https://www.oecd.org/general/searchresults/?q=SME%20response%20to%20COVID&cx=012432601748511391518:xze-adub0b0a&cof=FORID:11&ie=UTF-8>
17. <https://www.ebrd.com/news/2020/ebird-monitor-assesses-resilience-of-emerging-economies-to-covid19.html>
18. [https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/legal/COVID%20european%20measures\\_27\\_03.pdf?fbclid=I-wARO-JMYkBbKkt94vHkIXQMMLJozZx-StuORcPo56kCC1tmATsRnCGAyIU08](https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/legal/COVID%20european%20measures_27_03.pdf?fbclid=I-wARO-JMYkBbKkt94vHkIXQMMLJozZx-StuORcPo56kCC1tmATsRnCGAyIU08)
19. [https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/legal/COVID%20european%20measures\\_27\\_03.pdf?fbclid=I-wARO-JMYkBbKkt94vHkIXQMMLJozZx-StuORcPo56kCC1tmATsRnCGAyIU08](https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/legal/COVID%20european%20measures_27_03.pdf?fbclid=I-wARO-JMYkBbKkt94vHkIXQMMLJozZx-StuORcPo56kCC1tmATsRnCGAyIU08)
20. [https://www.researchgate.net/publication/320077409\\_E-commerce\\_and\\_Taobao\\_Villages\\_A\\_Promise\\_for\\_China's\\_Rural\\_Development](https://www.researchgate.net/publication/320077409_E-commerce_and_Taobao_Villages_A_Promise_for_China's_Rural_Development)
21. <https://import-export.societegenerale.fr/en/country/albania/e-commerce>
22. <https://www.information-age.com/covid-19-digitalisation-tech-boom-post-pandemic-123488670/>



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

## RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

**Dr. Diana Leka (Angoni)**

Drejtoreshë e Sekretariatit  
lekad@investment.com.al

**Elvis Zerva**

Ekspert Ligjor dhe Rregullator  
zervae@investment.com.al

**Elida Fara**

Eksperte Ekonomike  
farae@investment.com.al

**Xaira Shurdha**


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin  
shurdhax@investment.com.al

**Elisa Lula**

Oficere Administrative dhe Komunikimi  
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri  
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).